E PËRDITSHME
E PAVARUR
Drejtor:
FAHRI BALLIU
Kryeredaktor:
ILIR NIKOLLA
Nr. 171 (3889)
Viti XIII i botimit
*(numri i parë doli më 18.10.1997)*
E enjte,
9 korrik 2009

# 55

Adresa: Rruga "Medar Shtylla", qendra e biznesit
Tel: 04/2321364,
Tel: 04/2321366,
Fax:04/2321365,
Tiranë
E-mail:
info@gazeta55.net,
gazeta55mail@yahoo.com,
Internet:
www.gazeta55.al
Çmimi 30 lekë
Greqi 1,5 EURO

- KOMENT/4-

## Disa gazetarë, si "personazhet" e emisionit "Koha për t'u zgjuar"

Nga Feti Zeneli

Artikujt dhe komentet mediatike postzgjedhore, të një pjese gazetarësh të rreshtuar në skalionet partiako-politike të Edi Ramës, të kujtojnë ligjëratat vajtuese dhe anatemuese të disa qytetarëve të thjeshtë në emisionin "Koha për

# Nis përmbushja e kontratës së kryeministrit Berisha me shqiptarët

Rikthehet funksionimi normal i kabinetit qeverisës, me përmbushjen e zotimeve elektorale, të shqiptuara në fushatën e fundit zgjedhore. Ulja e moshës së pensionit për minatorët dhe përfshirja e letrave me vlerë në aksionin masiv të legalizimeve, dy vendimet e para të një sërë vendimesh që pritet të vihen në zbatim në 4 vitet e ardhshme nga qeveria "Berisha 2"

EDITORIAL/2

## Presidenti Topi dhe nënkryetari Spahiu përdorin KLD-në për interesa personale



Nga Fahri Balliu

KLD-ja ka qenë dje aktore e një shfaqjeje teatrale që solli në krye të Gjykatës së Tiranës një njeri të dëshiruar politikisht nga Edi Rama, dhe personalisht nga dyshja Topi-Spahiu.

Me këtë përzgjedhje, shpresohet që të vihet nën urdhra Gjykata e Tiranës, në mënyrë që ajo të shndërrohet në një apendiks, siç tashmë është verifikuar se po vepron Prokuroria.

## Në brendësi

Edhe kryetari i PSD-së e kuptoi më në fund kush e ka fajin për humbjen e opozitës

### Gjinushi, si kofini pas të vjelit, i mbetur pa asnjë mandat, akuzon Ramën, për asgjësim dhe vjedhje votash

Kryetari i Lëvizjes për Integrim Ilir Meta, flet për BBC-në

### "Lajtmotivi im, integrimi i Shqipërisë në Evropë - PS u bë pjesë e një basti personal të Edi Ramës"

- DITA/3 -

Zgjedhjet, Presidenti Sejdiu mesazh urimi kryeministrit Berisha

## "Shqipëria do të realizojë ëndrrën e kombit, me anëtarësimin e saj së shpejti në BE"

NOBEL
Shkolla 12-vjeçare jopublike
Shkolla që sfidon të ardhmen
REGJISTRIMET FILLUAN
Kontakto: 0692099430; 0692076801

EUROSIG
SIGURI E STANDARDEVE EUROPIANE
www.eurosig.al
Tel. : 04 2238-999

- FORUM -

### Koment/Serbia është shumë larg denazifikimit që kërkon prej saj BE-ja

Nga Skënder Mulliqi

### Përcillet në banesën e fundit mjeku Beniamin Çetta

### Tronditet Turkestani kinez nga viktimat dhe konflikti etnik

- SPECIALE/16-17-

## Shqipëria dhe shpëtimi i hebrejve

Nga Patrice Najbor

Shqiptarët ishin kombi që gjatë Luftës së Dytë Botërore ishin ndoshta të vetmin që treguan një mikpritje të veçantë ndaj hebrenjve, në kushtet e sundimit të ideologjisë naziste. Kjo sigurisht nuk ishte rastësi, pasi edhe më parë kur nazizmi nuk ishte në pozitat e luftës së hapur, në Shqipëri kishin gjetur mikpritje edhe hebrenj të tjerë, prej të

# Presidenti Topi dhe nënkryetari Spahiu përdorin KLD-në për interesa personale

*KLD-ja ka qenë dje aktore e një shfaqjeje teatrale që solli në krye të Gjykatës së Tiranës një njeri të dëshiruar politikisht nga Edi Rama, dhe personalisht nga dyshja Topi-Spahiu.*
*Me këtë përzgjedhje, shpresohet që të vihet nën urdhra Gjykata e Tiranës, në mënyrë që ajo të shndërrohet në një apendiks, siç tashmë është verifikuar se po vepron Prokuroria*

**Nga Fahri Balliu**

Dje Këshilli i Lartë i Drejtësisë konsumoi përzgjedhjen jashtëligjore e regresive që gazeta jonë kishte kohë që e paralajmëronte; emërimin e Artan Zenelit në krye të Gjykatës së Tiranës. Standardi i përzgjedhjes të kujton fort arrogancën që mbërtheu institucionet pas rebelimit të vitit 1997, kur në epiqendër nuk ishin interesat e shtetit, bile as ato të pushtetit, por veç interesat e ngushta të klanit, kryesisht të familjeve që kishin lidhje të forta me rebelimin. Pikërisht këto standarde antishtetërore u vunë re dje kur presidenti i Republikës Bamir Topi si dhe nënkryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë mbyllën sytë para alarmit mediatik, por edhe paralajmërimeve të ministrit të Drejtësisë, duke shpejtuar me ngut e në shkelje të plotë të procedurave të vendosnin të përzgjedhurin në detyrën delikate të përzgjedhur.

Sjellja e Topit dhe e Spahiut mua nuk më çudit e paralajmërime të kësaj natyre kam bërë edhe më herët, megjithatë tashmë është momenti që në interes të publikut, presidenti i republikës, së bashku me ndihmësin e tij në KLD të dëshmojnë se ç'interesa i shtyjnë të konfirmojnë kaq hapur pengmarrjen? Si është e mundur që krejt procedura u shkel, që me një vullnet të plotë drejtimi i Gjykatës së Tiranës u fut në krizë, iu kërkua pasardhësit që të jepte dorëheqjen dhe u soll njeriu i parapëlqyer, pa asnjë ditë gjyqtar, për t'u katapultuar para një jave si gjyqtar në detyrë e tashmë edhe si kryetar i saj. Kjo përzgjedhje ka qenë një rekrutim që vetëm me sistemin e drejtësisë nuk ka të bëjë, paçka se jam krejt i sigurtë se rekrutimi ka të bëjë me politikën si dhe me afera të tjera që prodhojnë interesa ekonomike. Me këtë përzgjedhje, në KLD u konfirmuan kuotat më të larta të kulturës së korrupsionit, ndërkohë që apelet e opinionit publik shpresohej që të pasoheshin me një qendrim më profesionist të anëtarëve të këtij institucioni, të cilët duhet të ndalin privatizimin prej dyshes së lartpërmendur, në mënyrë që pjesa tjetër të mos shndërrohet në një pjesëmarrje të një tufe delesh, që s'kanë zë e as mendim, por janë aty veç për praninë, bile edhe atë, rrezik pa asnjë lloj përfitimi.

Funksionimi i KLD-së si një kupolë apo edhe shfaqja teatrale që u vu në skenë dje nuk mund të fshehë interesin personal të dyshes Topi-Spahiu, por edhe interesin politik të Edi Ramës në këtë përzgjedhje. Pasqyrimi që mediat e majta i bënë gjatë ditës së djeshme shfaqjes teatrale të emërimit të Artan Zenelit në krye të Gjykatës së Tiranës konfirmojnë katërcipërisht interesin e Edi Ramës në këtë rekrutim, ndërkohë që optika e dyshes Topi-Spahiu është disi më e përcaktuar. Me këtë emërim, shpresohet që të vihet nën urdhra të drejtpërdrejta, vertikale, edhe Gjykata e Tiranës, në mënyrë që ajo të shndërrohet në një apendiks, siç tashmë po verifikohet se është kthyer edhe Prokuroria. Në emërimin e djeshëm, optika që ka udhëhequr procesin nuk ka qenë institucionale, por i ka ngjarë shtysave që çojnë njerëzit në themelimin e shpk-ve. Dje KLD-ja u vu në funksionim të interesave personale të presidentit Bamir Topi dhe nënkryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë Kreshnik Spahiu dhe ky është realiteti, për të cilin ne dje morëm akt. Në vështrim të parë, konfirmojmë regresin që po pëson institucioni i KLD-së, ndërkohë që merret vesh se parlamentit të ri i del edhe një detyrim i ri për të ndalur këtë spirale të rrezikshme në të cilën po futet drejtësia shqiptare.

*KLD-ja formalizon shkeljen e ligjit, voton Artan Zenelin kryetar të gjykatës së Tiranës. Akuzon Ministri i Drejtësisë Enkelejd Alibeaj*

# "Procesi i përzgjedhjes së kryetarit të Gjykatës së Tiranës, rasti më flagrant i kapjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë"

*TIRANE* – Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka formalizuar dje emërimin më të paprecedentë të një kryetari gjykate. Dhe ëpr ironi të kësaj, në thyerje të ligjit KLD-ja shembullin e keq të radhës e dha me emërimin e kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës.

Ndërsa në vigjilje të ditës përkujtimore të 1-vjetorit të rrëzimit të kandidaturës së Artan Zenelit (krahas kandidaturave të Zamir Poda, Mehdi Bici, Altina Xhoxhaj, Kristaq Traja) nga Parlamenti për anëtarë të Gjykatës së Lartë, Presidenti i bëri "dhuratën" e radhës këtij, dekretimin e kthimit në trupën gjyqësore të Shkallës së Parë të Tiranës, jo më larg se një muaj pas kësaj "dhurate", këtë herë jo vetëm Presidenti, njëherazi edhe Kryetari i KLD-ës, por pjesa dërrmuese e anëtarëve të saj (KLD-ës), "i hoqën pengun" e një viti më par, duke votuar këtë herë Artan Zenelin për kryetar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës, kur atij i duheshin të paktën edhe 3 vjet e më se 11 muaj, që në përmbushje të nenit 16 të ligjit Nr. 9877, datë 18. 02. 2008, "Për organizmin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë". -Ironia në këtë vendimmarrje në kundërshtim me ligjin shkonte më tej edhe për sa i përket faktin se dje, KLD-ja vetë, në përfundim të këtij votimi, i justifikoi shkeljet e procedurave deri në mbërritjen te ky votim farsë, me "vlerësimin e transparencës" se, Kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë Bamir Topi, kishte votuar për kandidatin Kastriot Selita dhe se Zëvendëskryetari Kreshnik Spahiu, kishte votuar për kandidaten Manjola Bejleri. I njëjti njoftim i KLD-ës, në justifikim të mosdhënies së arsyeve për shkeljet e rënda të ligjit, bënte të ditur gjithashtu (pa i interesuar askujt) se anëtari Neshat Fana dhe një anëtar tjetër i KLD-së (emri nuk i bëhet i ditur për arsye hetimi do thoshte policia në një njoftim të ngjashëm), votuan për kandidatin Petrit Çomo.



## Reagimi i ministrit Enkelejd Alibeaj

"Procesi i përzgjedhjes së kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ishte një proces tërësisht fals, jo transparent dhe i paramenduar. Ky është rasti më flagrant i kapjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë".

Kështu e ka përkufizuar dje Enkelejd Alibeaj, Ministri i Drejtësisë, mbledhjen e radhës së KLD-ës.

Duke dalë para gazetarëve në një konferencë për shtyp, Alibeaj bëri të ditur se fillimet e shkeljeve të ligjit dhe standardeve, u vërejtën që nga ndalimi i mediave për të ndjekur procesin e votimit për Kryetarin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës, sikurse ishte vepruar herët e mëparshme me votimet për kryetarët e gjykatave të tjera.

Më pas, Alibeaj është ndalur në denoncimin e procesit fals.

"Kandidatura e cila u përzgjodh si kryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është emëruar si gjyqtar jo më pak se një javë më parë. Jo vetëm kaq por procesi i përzgjedhjes ishte tërësisht në thyerje të ligjit. Ligji 'Për Organizimit dhe Funksionimin e Pushtetit Gjyqësor', kërkon së paku që gjyqtari, i cili do të kandidojë dhe që do të përzgjidhet duhet të jetë anëtar i kësaj gjykate dhe i kësaj trupe gjyqësore jo më pak se 4 vjet", sqaroi Ministri Alibeaj.

Përpos kësaj, Alibeaj shpjegoi më tej se, kandidaturat në këtë garë, duhet të kishin marrë më parë vlerësime nga KLD-ja, gjë që nuk ka ndodhur.

"Do të duhet që të gjitha kandidaturat të kishin vlerësimin nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, vlerësim profesional, shumë mirë madje, me 'notën shumë mirë', për dy herë.

Për asnjërën nga kandidaturat nuk kishte një vlerësim të tillë kjo në thyerje tërësisht të ligjit", vijoi më tej Alibeaj.

Duke komentuar procesin, Ministri i Drejtësisë, e quajti atë si të paramenduar, dhe si një rast flagrant të kapjes së KLD-ës.

"Ky ishte një proces i paramenduar dhe ky është rasti më flagrant i kapjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Është rasti më flagrant dhe mesazhi më i keq që i çohet sistemit gjyqësor. Mesazhi më i keq që i çohet zbatimit të reformave ligjore, të reformave të sistemit gjyqësor. Është rasti më energjik i nëpërkëmbjes së ligjit, i nëpërkëmbjes së shtetit. Është rasti i cili ka caktuar sot njollën më të errët të sistemit gjyqësor dhe të institucioneve të tij", deklaroi Ministri i Drejtësisë. Duke ju përgjigjur më pas interesimit të gazetarëve, për "lëvizjen e radhës", Alibeaj shpjegoi se zgjidhja e vetme është, "denoncimi i rastit në ato institucionet të cilat do të duhet të zbatojnë ligjin. Ata që kanë votuar për të thyer ligjin, ata do të mbajnë përgjegjësi", përfundoi Ministri i Drejtësisë, Enkelejd Alibeaj.

## (Mos)justifikimi i KLD-së

Pas votimit të djeshëm, ka reaguar edhe KLD-ja, nëpërmjet një njoftimi zyrtar. Pa dhënë asnjë përgjigje për akuzat e Ministrit të Drejtësisë, për shkeljen e ligjit, procedurave dhe standardeve, KLD-ja nuk ka bërë asgjë më shumë të ditur justifikimet nëpërmjet zbulimit të votave "kundër" për Artan Zenelin, përpos njoftimit që gjithsesi ky ishte zgjedhur Kryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës. "Këshilli me shumicë të votave, vendosi emërimin e Zotit Artan Zeneli, në pozicionin e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë të kryeqytetit. Në vlerësim të transparencës gjatë procesit të vendimmarrjes, Kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë SH. T. Z. Bamir Topi deklaroi se vota e tij shkoi në favor të kandidatit Kastriot Selita - aktualisht Kryetar i Gjykatës së rrethit gjyqësor Dibër. Rezultatet e votimit në favor të kandidatit Zeneli, përjashtuan edhe Zëvendëskryetarin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë Z. Kreshnik Spahiu, i cili votoi në favor të kandidates Manjola Bejleri, si dhe anëtarin Neshat Fana e një anëtar tjetër të KLD-së, të cilët votuan në favor të kandidatit Petrit Çomo", shpjegonte zyrtarisht KLD-ja, (mos)justifikimin e vet për shkeljen e ligjit, procedurave dhe standardeve në mbledhjen e saj të djeshme.

Më tej, nëpërmjet të njëjtit njoftim, KLD-ja na jepte edhe "sihariqin" se, "Ministri i Drejtësisë Enkelejd Alibeaj, nuk votoi për asnjë kandidat pasi mbajti qëndrimin se nuk janë plotësuar të gjitha kriteret ligjore për emërimin e kryetarit të gjykatës". Për turpin e vet, KLD-ja vijonte dje në mënyrën më tallëse, sërish me veten e vet, t'i bënte "reklamë" Artan Zenelit, duke u katandisur në nivelin e një agjencie publicitare. Në (mos)justifikim të shkeljeve të ligjit, procedurave dhe standardeve, KLD-ja na bënte të ditur se, "Artan Zeneli, u riemërua në detyrën e gjyqtarit të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe dekret Nr. 6207, Datë 12.06.2009 të Presidentit të Republikës. Gjyqtari Zeneli ripërfshihet në sistemin gjyqësor pas një periudhe shkëputje prej ushtrimit të detyrës së gjyqtarit, detyrë të cilën ai e ka ushtruar për 8 (tetë) vjet pranë gjykatave të rretheve gjyqësore Krujë dhe Tiranë; duke sqaruar se në gjykatën e kryeqytetit, ai ka ushtruar edhe funksionin e zëvendëskryetarit për periudhën 1993 – 1995".

### *Zgjedhjet, Presidenti Sejdiu mesazh urimi kryeministrit Berisha*

## “Shqipëria do të realizojë ëndrrën e kombit, me anëtarësimin e saj së shpejti në BE”

*TIRANE - Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu ka uruar kryeministrin Sali Berisha për fitoren e koalicionit që ai drejtoi në zgjedhjet e 28 qershorit dhe marrjen e përkrahjes nga qytetarët e Shqipërisë për të qeverisur vendin edhe në mandatin e ardhshëm. Në urimin e tij, presidenti Sejdiu shpreh se “në emër të popullit dhe të institucioneve të Republikës së Kosovës, Ju përgëzoj për fitoren e 28 qershorit në të cilën ‘Koalicioni për Ndryshim’ mori përkrahjen e qytetarëve të Shqipërisë për të qeverisur vendin Tuaj në mandatin e ardhshëm”.*

*Presidenti Sejdiu në letrën e tij vlerëson procesin e zhvilluar zgjedhor në Shqipëri, i cili sipas tij, u dha votuesve shqiptarë mundësinë që të përcaktohen të lirë për përfaqësuesit e tyre.*

*“Jam i bindur se Shqipëria, e qeverisur nga koalicioni i ndërtuar mbi vlera të demokracisë dhe të zhvillimit, do të vazhdojë me hapa të vendosur që kombi dhe shteti shqiptar të bëhet pjesë e familjes së gjerë evropiane, duke marrë kështu detyrimet dhe përgjegjësitë që i takojnë. Besoj se Shqipëria, pas anëtarësimit në NATO, në një kohë fare të shkurtër, do të përmbushë kriteret për t’u bërë anëtare e Bashkimit Evropian, duke realizuar kështu një nga dëshirat dhe ëndrrat më të mëdha të kombit shqiptar”, theksohet më tej në letër.*

*“Ju siguroj me këtë rast se, si president i Republikës së Kosovës, do të punoj ngushtë së bashku me Ju për të thelluar bashkëpunimin në interes të të dy vendeve tona si dhe gjithë rajonit. Duke Ju përgëzuar edhe një herë, Ju dëshiroj fat dhe sukses në punën Tuaj për të mirën e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë”, thuhet në fund të urimit, të Presidentit të Kosovës Fatmir Sejdiu.*

Leonard Quku

# Nis përmbushja e kontratës së kryeministrit Berisha me shqiptarët

***Rikthehet funksionimi normal i kabinetit qeverisës, me përmbushjen e zotimeve elektorale, të shqiptuara në fushatën e fundit zgjedhore. Ulja e moshës së pensionit për minatorët dhe përfshirja e letrave me vlerë në aksionin masiv të legalizimeve, dy vendimet e para të një sërë vendimeve që pritet të vihen në zbatim në 4 vitet e ardhshme nga qeveria “Berisha 2”***

*TIRANE* - Pak më shumë se një javë nga zhvillimi i zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare, kryeministri Sali Berisha ndërmerr nismat e para për të kthyer në realitet premtimet e bëra gjatë fushatës elektorale. Qeveria e kryeministri Berisha, ka shndërruar në ligje disa nga premtimet e bëra gjatë fushatës elektorale. Ulja e moshës për daljen në pension të minatorëve, rimbursimi brenda një muaji e TVSH për bizneset, futja në përdorim e letrave me vlerë në tregun e legalizimeve dhe shkurtimi i shpenzimeve operative me 10 për qind, ishin çështjet kryesore të diskutuara dje në mbledhjen e radhës të Këshillit të Ministrave.

Gjatë gjithë fushatës elektorale të muajit të kaluar, kryeministri Berisha i premtoi minatorëve të të gjithë vendit se qeveria do të ulë moshën e pensionit për ta, me 5 vjet. Rimbursimi i TVSH për bizneset, ishte një tjerr premtim e qeverisë Berisha, sikurse edhe futja në treg e letrave me vlerë për procesin e legalizimeve. Futja në përdorim e letrave me vlerë në tregun e legalizimeve, do të kërkojë ndryshim në ligjin e legalizimeve. Në këtë të fundit përcaktohet se legalizimi bëhet në vlerë monetare ndaj dhe ndërhyrja në ligj do të synojë përcaktimin, se 80 për qind e objektit për legalizim do të bëhet me letra me vlerë.

***Ulet me 5 vjet mosha e daljes në pension të minatorëve***

Kryeministri Berisha e konsideroi vendimin përmbushjen e një premtimi elektoral të qeverisë për këtë kategori. “Minatorëve iu premtua ulja e moshës së pensionit me 5 vite. Edhe ky ligj shkon në parlament. Minatorët në Shqipëri nuk do të dalin 65 vjeç në pension, por 60-të”, tha Berisha. Shefi i ekzekutivit bëri të ditur gjithashtu se Ministria e Financave do të paraqesë edhe skemën për rritjen e pensionit për minatorët. “Ministria e Financave, ka marrë porosi dhe udhëzimin që të paraqesë skemën e rritjes së pensioneve të tyre, që minatorëve u është premtuar, së bashku me uljen me 5 vjet të moshës së pensionit. Ne duhet të jemi realistë. Ata kanë qenë njerëzit që kanë kontribuar në të ardhurat kombëtare më shumë dhe që kanë marrë më pak. Tani është koha që pensionet e tyre të rivlerësohen, në mënyrë që edhe ata të ndjejnë qëndrim të ri ndaj tyre”, deklaroi kryeministri Berisha

***Rimbursimi i TVSH, për bizneset***

Këshilli i Ministrave vendosi dje që për Tatimin e Vlerës së Shtuar ose TVSH, të rimbursohet bizneseve brenda një muaji. Premtim që sipas kryetarit të qeverisë do t’i japë fund arbitraritetit në këtë fushë.

Uljen e taksës së tabelës në 1 euro, kryetari i qeverisë ua premtoi edhe biznesmenëve të atij, që njihet si tregu çam në Tiranë. Vendimit të qeverisë i shtohet dhe detyrimi i vendosjes së emërtimeve në shqip, përjashtuar këtu filialet e huaja.

Qeveria vendos që taksa për tabelat emërtuese të jetë një euro.

Kryeministri Berisha tha se nga ky vendim do të përfitojnë vetëm ata që emërtesat në tabelat e tyre i kanë në gjuhën shqipe, duke përjashtuar emërtesat e filialeve të kompanive të huaja.

“Taksa e tabelës do të jetë një euro, me kusht që tabelat të kenë emërtesë shqip. Askush nuk do të mund të na vendosë emra të huaj në to, por në gjuhën shqipe. Në rast të kundërt, nuk përfitojnë nga ky ligj. Unë mendoj se në të gjithë vendin duhet të kemi një standard të tillë, përveç atyre që janë filiale të kompanive të huaja.”

***Shkurtohen shpenzimet operative me 10 për qind***

Kryeministri Sali Berisha kërkoi dje në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, që të shkurtohen shpenzimet operative në masën 10 për qind, pasi sipas tij “jemi në një kohë kur ekonomia botërore po kalon një krizë financiare”. Gjithashtu, Kryeministri Berisha udhëzoi ministrat e kabinetit qeveritar, që deri në fund të muajit korrik, të finalizohet projekt-buxheti i vitit 2010.

Lidhur me këtë, Kryeministri Berisha kërkoi që ky buxhet të jetë buxheti i antifragmentarizmit. Kryeministri theksoi se është mjaft e rëndësishme që në këtë buxhet të ketë përqendrim në projektet më të mëdha dhe qenësore, në mënyrë që të mos shkohet në fragmentim.

“Fragmentimi është një dukuri që e avullon buxhetin dhe e bën atë të pandjeshëm”, tha kryeministri Berisha.

Kreu i qeverisë u shpreh se në hartimin e projekt-buxhetit të vitit 2010, ministritë e kabinetit qeveritar do të asistohen në çdo hap dhe në mënyrë permanente nga Ministria e Financave



***Përdorimi i letrave me vlerë në procesin e legalizimit***

Qeveria miratoi dje edhe vendimin për disa ndryshime në ligjin për “Për legalizimin, urbanizmin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. Kryeministri Berisha u shpreh se këto ndërhyrje në ligjin e legalizimeve bëhen në përputhje me premtimin elektoral, për të lejuar përdorimin e letrave me vlerë, në pagesën e ndërtimeve që do të legalizohen. “Lidhur me letrat me vlerë, pas një analize shumë serioze të juristëve, ata mendojnë se duhet të ndërhyhet patjetër në ligjin e legalizimeve, pasi ky ligj ka të përcaktuar që pagesa bëhet në lekë. Kështu që duhet të ndërhyjmë në ligj, në përputhje me premtimin e bërë. 80 për qind të vlerës të të gjithë sipërfaqes që i takon në përputhje me ligjin do ta paguajnë me letra me vlerë”, tha Berisha.

Kryeministri sqaroi se për sipërfaqet jashtëligjore, që ligji e parashikon me vlerë tregu, 50 për qind e tyre do të paguhen me letra me vlerë.

“Në qoftë se një personi i takon të legalizojë banesën dhe 300 m2 në përputhje me ligjin, ai 80 për qind do t’i ketë, pra, ashtu siç janë përcaktimet ligjore. Sipërfaqja ekstra, që është jashtë parashikimit ligjor të procesit të legalizimit dhe që është parashikuar të paguhet me vlerën e tregut, do të jetë 50 me 50.” u shpreh kryeministri.

Kryeministri shtoi gjithashtu qeveria ul në masën 0.5 për qind të vlerës së banesës për legalizim, taksën e infrastrukturës “Është bërë dhe një ndërhyrje jashtëzakonisht e domosdoshme për procesin e legalizimit, është ulur taksa e infrastrukturës. Duke qenë se ky është një proces masiv është vendosur që kjo taksë të jetë 0.5 për qind e vlerës së banesës për legalizim”.

***Taksat e tabelave reklamuese në qytetet dhe rrugët e vendit***

Këshilli i Ministrave miratoi dje vendimin, i cili ndër të tjera, përcakton rritjen e taksës së tabelave të reklamave, në qytetet dhe rrugët e vendit. Kryeministri u shpreh se kjo masë ndërmerret për t’u ardhur në ndihmë autoriteteve vendore dhe për të kufizuar në një shkallë ndotjen vizive që transmetojnë reklamat, në rrugët dhe qytetet e vendit.

“Do të rritet në mënyrë të ndjeshme taksa e tabelave të reklamave, në qytetet dhe rrugët e Shqipërisë. Deri më sot, kjo taksë ka qenë shumë e ulët, ka qenë qesharake, ndërsa tani merr një vlerë të re, të rëndësishme. Kjo masë ndërmerret për të ndihmuar autoritetet vendore, por edhe për ta kufizuar në një shkallë ndotjen vizive që japin reklamat për të cilat sot ka tendencë botërore drejt kufizimit të tyre”, tha kryeministri.

Gjithashtu Këshilli i Ministrave miratoi vendimin për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për lojërat e fatit”, i cili ka si qëllim rishikimin e niveleve të tarifave fikse për kazinotë, duke rritur nivelin e tyre, në krahasim me nivelet që aplikohen aktualisht.

Ndër të tjera në mbledhjen e qeverisë u miratua vendimi për një ndryshim në ligjin “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, në të cilin përcaktohet rritja e akcizës për pijet alkoolike, kafen dhe duhanin. Vendimi synon përafrimin e nivelit të akcizës, për këtë kategori mallrash, me nivelet e rajonit, si dhe me nivelet e BE-së.

***Ndërtuesit, punë me tre turne për ndërtimin e veprave publike***

Në mbledhjen e djeshme të qeverisë, kryeministri Sali Berisha kërkoi nga Ministri i Punëve Publike ngritjen e një Task Force, për ndjekjen dhe zbatimin me përpikëri të Vendimit të Këshillit të Ministrave, i cili përcakton punën me tre turne të firmave ndërtuese, të angazhuara në vepra publike.

Duke vlerësuar shumë të rëndësishëm faktorin kohë, Kryeministri tha se do të ndërmerren masa ligjore, të parashikuara në ligj, për ata që nuk e zbatojnë këtë vendim.

“Zoti Ministër i Punëve Publike, konstatohet se një seri firmash nuk punojnë turni i tretë. Kërkoj ngritjen e një Task Force nën drejtimin tuaj personal dhe zbatimin me rigorozitetin më të madh të ligjit. Koha është më e çmuara për ne. Këta zotërinj kur fitojnë tenderët, e pranojnë vendimin e qeverisë për punën me tre turne. Natyrisht ky vendim nuk mund të zbatohet në çdo kohë klimaterike, por tani e deri në tetor, ai që nuk e zbaton këtë vendim, duhet të ndëshkohet në përputhje me ligjin. Ndëshkimet janë të mjaftueshme, por po të jetë e nevojshme, do t’i shtojmë. Çdo kompani duhet ta ketë të qartë se për ne koha ka çmimin më të lartë”.

KOMENT

# Disa gazetarë, si "personazhet" e emisionit "Koha për t'u zgjuar"

Nga Feti Zeneli

Artikujt dhe komentet mediatike postzgjedhore, të një pjese gazetarësh të rreshtuar në skalionet partiako-politike të Edi Ramës, të kujtojnë ligjëratat vajtuese dhe anatemuese të disa qytetarëve të thjeshtë në emisionin "Koha për t'u zgjuar", të cilët vazhdojnë të "trimërohen" step by step, këto ditë, në anën tjetër të telefonit, megjithë këshillat e gazetarit të mirënjohur z. Bashkim Hoxha për "qytetari dhe maturi" në fjalorin apo logjikën që përdorin. Por të tillë telendarë mezi i frenon kur i ke ballëpërballë dhe jo disa kilometra larg të fshehur pas receptorit të telefonit, ndaj në disa raste, z, Hoxha, me mjaft edukatë e mirësjellje detyrohet t'i paralajmërojë se, "do t'ju mbyll telefonin, nëse vazhdoni më këtë fjalor". Megjithatë reflektimi është mjaft i rrallë. Sidoqoftë "mbyllja e telefonit" është një zgjidhje për t'u mbyllur gojën këtyre individëve dhe për t'u hapur sytë e veshët e ndërgjegjes dëgjuesve të shumtë, paçka se ngjan një mënyrë jo shumë demokratike. Po ç'të bësh kur "telefoni" ka formën e kolonave të shkrimit në gazetë apo mikrofonave në studiot televizive dhe disa gazetarë i përdorin këto mundësi komunikimi në të njëjtën mënyrë siç bëjnë një pjesë qytetarësh në emisionin "Koha për t'u zgjuar". Natyrisht ata nuk flasin me gjuhën rrugaçërore apo armiqësore të "personazheve" të Bashkim Hoxhës duke e quajtur Ilir Metën; "qen", "qelbësirë", "i pabesë", "kollovar", etj., por në vlerësimet që bëjnë dhe opinionet që japin e dënojnë kryetarin e LSI-së për pjesëmarrjen në koalicionin qeverisës me Partinë Demokratike dhe aleatët e saj. Disa tituj shkrimesh dhe artikulime televizive të tyre, të cilat vlerësojnë si të drejta vetëm veprimet dhe fjalimet e Edi Ramës, duke kundërshtuar çfarëdo zgjidhjeje tjetër që vjen nga kundërshtarët e tij politik a partiakë, ta shpifin më shumë sesa fjalët banale që përdorin qytetarë të veçantë në emisionin e Bashkim Hoxhës. Është fatkeqësi që mentaliteti i këtyre gazetarëve të bjerë në nivelin e militantizmit të disa njerëzve të rëndomtë, të cilët kujtojnë se akoma votojnë si në kohën e Enverit, kur vota konsiderohej "plumb për armikun", duke mos e kuptuar se, në këtë rast gazetaria nuk është më një mision publik, por shndërrohet në agresion politik.

Dhe është e rëndë për një vend demokratik, kur ky "agresion" maskohet me petkun e pavarësisë së "pushtetit të katërt". Kujtdo mund t'i falet shpërdorimi i demokracisë, por kurrsesi gazetarëve që konsiderohen si misionarë të fjalës së lirë. Kohë më parë, këtë gjuhë e gjykim gazetaresk mezi pranonim ta shihnim edhe në faqet e gazetës "Zëri i Popullit", artikujt e së cilës reflektonin ende ideologjinë e "trakteve partizane". Por ka disa muaj që ajo ka ndryshuar shumë në paraqitje, qëkurse Erion Braçe u zëvendësua si kryeredaktor. Sidoqoftë, kjo është një strategji e Edi Ramës, për t'ua transemtuar disa gazetave e mediave të tjera, gjasme të pavaruara, misionin 67-vjeçar të gazetës "Zëri i Popullit", pasi në këtë mënyrë efekti i "kushtrimit partizan" përçohet më mirë tek "socialistët e thjeshtë të ditëve tona". Kësisoj, militantët e majtë nuk na dalin më "egërsira" sesa disa gazetarë të pavarur, që duan "të hanë mish njeriu" për pushtet. Ishte e justifikueshme njëfarë ekstremizimi gazetaresk para zgjedhjeve të 28 qershorit, me qëllim që të ndikonin sa më shumë në elektorat, për ta "binduar" atë të votonte për Edi Ramën. Po tani që humbi Rama, kujt i duhet një ekstremizëm i tillë? Ai nuk mund të merret as si "këngë vaji", nëse këta gazetarë nuk e kanë kuptuar akoma se humbja e Edi Ramës nuk është "përmbysje e botës" në interesat e tyre të ngushta materiale.



Por në të vërtetë, humbja e Edi Ramës është fitore e Shqipërisë, pasi në të kundërt vendi do të binte në duartë e një aventurieri të papërgjegjshëm. Kjo gjë u paralajmërua qysh para fillimit të fushtës elektorale, kur Edi Rama dhe klientët e tij të lejeve të ndërtimit iu futën "detit në këmbë", pa një program të qart qeverisës. Do isha shumë i lumtuar sikur këta ithtarë të paparë të Edi Ramës të më kujtonin qoftë edhe një objektivë konkrete të programit elektoral të PS. Kësisoj fushata u konceptua si një betejë luftarake, që fitohet duke sulmuar dhe asgjësuar kundërshtarin. Ishte kjo arsyeja që në debatet publike të ishkandidatëve për deputetë, nga përfaqësuesit e Edi Ramës dëgjonim vetëm "oponencë" të arritjeve qeverisëse të demokratëve dhe thirrje që të mos e votonin Ilir Metën, pasi "vota për të është votë për Berishën". Pra ai e përgatiti "ushtarakisht" kryesinë dhe anëtarësinë e Partisë Socialiste për zgjedhjet e 28 qershorit '09, të cilat jo vetëm nga komuniteti ndërkombëtar, por edhe nga shqiptarët shikoheshin si një rast i art për t'u shfrytëzuar lidhur me mbylljen e ciklit të integrimit të vendit në Bashkimin Europian. Protestat e Fierit dhe artikulimet e përditshme revolucionare nga foltorja e selisë së PS-së janë "vazhdim i politikës me mjete të tjera", sikundër e përkufizon "luftën" teoria marksiste-leniniste. Kur shikon sjellje e veprime të tilla të Ramës dhe përfaqësuesve të tjerë politikë të Partisë Socialiste, nuk ka se si, mirënjohja të mos shkojë tek ata qindëra mijë shqiptarë, të cilët ia treguan vendin me votë këtij njeriu të papërgjegjshëm, por edhe tek vendimi i Ilir Metës dhe mjaft politikanëve të tjerë të përgjegjshëm të LSI-së për të shmangur këtë moment krize, duke iu bashkëngjitur qeverisjes së "Aleanca e Ndryshimit". Fjala ishte për një qeverisje të qëndrueshme, pasi me 71 deputetë "Koalicioni i Ndryshimit" e krijonte i vetëm qeverinë. Por nëse Ilir Meta nuk do të përfshihej në koalicionin qeverisës, atëherë Rama do ta kishte më të lehtë të sulmonte qeverinë "Berisha 2" dhe të krijonte destabilitet në vend. Por Meta u soll si një politikan dhe shqiptar i vërtetë në këtë situatë, duke i hequr kështu çdo mundësi Ramës që të luaj më tej me fatet e Shqipërisë dhe demokracisë. Kësisoj, unë ua fal "personazheve" të emisionit "Koha për t'u zgjuar" ta shajnë mbarë e mbrapsht Ilir Metën apo të thonë se, "Iliri më mirë të bashkohej me serbin sesa me Berishën", por nuk ua fal këtë gjuhë armiqësore disa gazetarëve të papërgjegjshëm që e njollosin këtë profesion të nderuar duke e anatemuar me të njëjtin fjalor kryetarin e LSI-së dhe veprimin e tij për të bashkëqeverisur me Sali Berishën. Ata nuk janë kaq vulgarë e injorant që nuk e dinë se, ku të çonte qëndrimi "përtej të majtës e të djathtës" i Ilir Metës, në një kohë që Shqipëria pret miratimin e statusit të vendit kandidat për në BE dhe liberalizimin e shpejt të vizave me vendet e Bashkimit Europian. Aq më tepër e dinë se, ç'krizë prodhon bashkimi i LSI-së me PS-në në emër të "idealeve komuniste e partizane", duke krijuar një opozitë me 69 deputetë dhe një mazhorancë me 71 deputetë. Bashkëqeverisja e të djathtës me një parti apo fraksion të majtë nuk është ndonjë "çudi shqiptare", pasi në Europë ka plot shembuj të tillë. Nga ana tjetër për ne, kjo nuk është një dukuri e viteve dymijë por një eksperiencë e viteve nëntëdhjetë.

Të gjithë e kanë parasysh që qysh pas zgjedhjeve të 22 marsit '92, në qeverinë e demokratëve, të kryesuar nga Aleksandër Meksi ishte përfshirë edhe partia e Skënder Gjinushit, që kryesohet nga një prej komunistëve më ekstremistë të këtij vendi. Në atë kohë nuk patëm anatemime apo paragjykime të tilla, megjithëse të majtët e asaj kohe ishin më fanatikë se sot. Po cila është arsyeja, që "armiqësinë për së gjalli", midis të majtës dhe të djathtës në Shqipëri ta shikojmë më prezente dhe më kërcënuese se kurrë sot, pas 17 vitesh demokraci? Sigurisht, brumosja me idealet e "revolucionit demokratik të vonuar" të '97-ës dhe "pluralizmin e Pezës" të kryesocialistit Edi Rama, i cili mbështetësit e vet në mëngjes i nxjerrë tek emisioni "Koha për t'u zgjuar", duke i këshilluar të thonë se, "jemi nga Skrapari, Vlora dhe Fieri", dhe në darkë, tek redaksitë e gazetave dhe ekranet e televizioneve për të sharë e shkruar, këto ditë, për "tradhtitë e Ilir Metës" që e bashkua me Sali Berishën, që po punon për të mirën e Shqipërisë dhe jo me Edi Ramën që iu prishën projektet e bashkëpunimit qeveritar me "klientët-ndërtues" të Bashkisë. "Jemi këputur në mes duke votuar për Ilir Metën", tha një "opinioniste" në emisionin "Koha për t'u zgjuar", duke të krijuar kështu ndjesinë se ishte ngarkuar me "bomba e fishekë", që disa gazetarë mendjelehtë i bëjnë objekt shkrimesh në gazetë. "Bir Selman i nënës, kë të qaj më parë…", këndojnë në jug një këngë vaji. Por, nëse perifrazojmë vargjet e kësaj kënge për të ilustruar realitetin e mësipërm, atëherë dilema se, "kë të qajmë më parë…" është e zgjidhur në disfavor të disa "personazheve" të emisionit "Koha për t'u zgjuar"…

**Po ç'të bësh kur "telefoni" ka formën e kolonave të shkrimit në gazetë apo mikrofonave në studiot televizive dhe disa gazetarë i përdorin këto mundësi komunikimi në të njëjtën mënyrë siç bëjnë një pjesë qytetarësh në emisionin "Koha për t'u zgjuar". Natyrisht ata nuk flasin me gjuhën rrugaçërore apo armiqësore të "personazheve" të Bashkim Hoxhës duke e quajtur Ilir Metën; "qen", "qelbësirë", "i pabesë", "kollovar", etj., por në vlerësimet që bëjnë dhe opinionet që japin e dënojnë kryetarin e LSI-së për pjesëmarrjen në koalicionin qeverisës me Partinë Demokratike dhe aleatët e saj**

### Edhe kryetari i PSD-së e kuptoi më në fund kush e ka fajin për humbjen e opozitës

# Gjinushi, si kofini pas të vjelit, i mbetur pa asnjë mandat, akuzon Ramën, për asgjësim dhe vjedhje votash

TIRANE – Skënder Gjinushi, një nga "të rinjtë e politikës së re" të Edi Ramës që u bë pjesë e kësaj thashethеme dhe që konkurroi në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, duke marrë si përfitim skarcitetin politik vetëm dje gjeti momentin të shigjetojë kryesocialistin ende në detyrë.

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje politike dhe pas pretendimeve për një përfaqësim të mundshëm në legjislaturën e ardhshme parlamentare, një nga xhaketat e vjetruara të politikës shqiptare, ishministër i diktaturës, Skënder Gjinushi hedh akuza në drejtim të Edi Ramës, për dështimin e thellë të së majtës në zgjedhjet e 28 qershorit dhe se PS i ka vjedhur votat PSD-së, duke ndërmarrë një proces shkatërrimi për partitë e tjera të kampit të majtë. Gjinushi deklaroi se Edi Rama dhe Partia Socialiste i kanë vjedhur votat dhe se kanë implementuar një strategji shkatërruese për partitë e vogla, specifikisht PSD-në, një aleate e gjithëkohshme e PS-së, ardhur kjo nga trashëgimia e përbashkët, ajo komuniste, e partisë më të madhe në opozitë dhe Skënder Gjinushit.

Pas një heshtje 10 ditore që pasoi procesin zgjedhor të 28 qershorit Skënder Gjinushi shfaq hapur dhe publikisht pakënaqësitë ndaj Partisë Socialiste dhe Edi Ramës.

Sipas tij, ligji i ri zgjedhor ka si synim kryesor të asgjësojë partitë e vogla politike. Ndërkohë, që Gjinushi e bën këtë deklaratë tani pas zgjedhjeve, kur ka mësuar se tashmë nuk është pjesë aktive e politikës dhe se ka humbur karrigen e deputetit.

Gjinushi heshti, nuk iu kundërvu Edi Ramës kur propozoi sistemin e ri zgjedhor dhe që u miratua me konsensusin e PD, pasi kishte marrë premtimin nga Edvini që nëpërmjet votave të trafikuara dhe të vjedhura, PS dhe PSD do të mbeteshin në politikë. Pas dështimit të këtyre planeve famëkeqe, pas dështimit të Edi Ramës dhe PS, Gjinushi ndjehet i braktisur dhe sigurisht do të shigjetojë atë që e mashtroi, Edi Ramën.

I mbetur pas asnjë mandat në kuvendin e ri, Skënder Gjinushi, kryetar i PSD, fokusohet edhe tek bashkëpunimi PD-LSI të cilin në dy fjalë e konsideroi pazar politik.

### Kryetari i Lëvizjes për Integrim Ilir Meta, flet për BBC-në

# "Lajtmotivi im, integrimi i Shqipërisë në Evropë - PS u bë pjesë e një basti personal të Edi Ramës"

Kryetari i LSI-së, Ilir Meta, tha për BBC-në se vendimi për të bashkëpunuar me PD-në për krijimin e koalicionit qeverisës i shërben vendit, por edhe seriozitetit dhe identitetit të LSI-së, e cila në radhë të parë është në funksion të integrimit evropian të vendit. Ai ka përsëritur akuzat në adresë të lidershipit të PS-së për atë që ai e quan përpjekje për asgjësimin korruptiv të LSI-së gjatë këtij procesi zgjedhor.

**Cila është përmbajtja e marrëveshjes me Berishën për t'u bërë pjesë e koalicionit qeverisës?**

Nuk kemi bërë asnjë bisedim deri tani përveçse kemi dhënë një përgjigje "po" në parim për bashkëqeverisje me PD- në si fituese e këtyre zgjedhjeve me qëllim realizimin e një qeverisjeje të qëndrueshme dhe në funksion të reformave të integrimit evropian. Në ditët në vijim besoj se do kemi një takim të parë me kryetarin e PD-së dhe natyrisht fokusi kryesor do të jetë në programin e koalicionit qeverisës. Ndërsa për sa i takon funksioneve kjo mendoj që është një çështje sekondare.

**Unë e ndoqa konventën tuaj në sallën e Teatrit të Operës, dhe ndjeva entuziazëm te pjesëmarrësit kur ju shpallët apo kërkuat nga Konventa mendimin e saj për pjesëmarrjen tuaj në qeverisje. Ndërkohë pati edhe zëra kundër. Pëllumb Xhufi tha se do ishte më mirë një mospjesëmarrje në këtë qeveri. Ju vetë si e pritët këtë zë kundër, por dhe disa zëra të tjerë brenda partisë?**

Meqenëse ju paskeni pasur fatin për ta ndjekur drejtpërdrejtë besoj se e keni vënë re se në ç'mënyrë demokratike u realizua konventa. Ka dy zëra kundër që ne i respektojmë, do donim të kishim një propozim për rrugëzgjidhjen sepse doli qartë që LSI ishte para dy alternativave, ose të bashkëpunonte me PS, e cila ka një përgjegjësi të madhe për cenimin e standardeve duke futur vendin në një proces krize, ose të bashkëpunonte me koalicionin fitues për të realizuar një qeverisje të qëndrueshme dhe në dobi të integrimit evropian të vendit. Pra, edhe ata dy zëra kundër, të cilët edhe pse unë u luta aty në Konventë, nuk na dhanë dot as edhe një zgjidhje tjetër dhe nuk na sqaruan një rrugë të tretë përveç këtyre të dyjave. Pa diskutim që kjo është rruga më e drejtë, ku duhet të eci LSI sepse i shërben vendit, por natyrisht besoj që do i shërbej dhe seriozitetit dhe identitetit të LSI-së, e cila në radhë të parë është në funksion të integrimit evropian të vendit.

**Ju jeni një parti e majtë, mirëpo të majtët e tjerë, siç foli dhe Gramoz Ruçi për BBC-në, e quajnë akt tradhtie këtë marrëveshje tuajën për të qenë në qeveri bashkë me Sali Berishën...?**

Shprehje të tilla si tradhtar janë të denja për një politikan të politikës së re si Gramoz Ruçi. Ka qenë një ndër ekzekutorët kryesorë të skenarit të Ramës, për asgjësimin korruptiv të LSI-së gjatë këtij procesi zgjedhor. Tradhti është që në këto momente të rëndësishme të inskenosh destabilizim të vendit sikurse bën Ruçi dhe sikurse u përpoq të bënte dhe ne Fier pas zgjedhjeve. Tradhti ndaj të majtës është të vazhdosh t'i shërbesh një klike ndërtuesish dhe mafiozësh në PS, sikurse bën Gramoz Ruçi dhe jo të reflektosh për këtë humbje të thellë e cila më shumë sesa numerike është morale dhe politike, pasi një parti e tërë me vlera shumë të mëdha si PS, u bë pjesë e një basti personal të Edi Ramës, që nuk ka asnjë lidhje me vlerat tradicionale të PS. Prandaj ne do të ecim përpara, pa u kushtuar vëmendje folklorizmave të tillë, qoftë kur vijnë nga Ruçi e qoftë kur vijnë nga Rama, e besojmë që kjo është rruga që ndihmon dhe PS-në, që t'u rikthehet atyre vlerave të demonstruara në 18 vjet, por të mohuara gjatë viteve të fundit të një lidershipi pa identitet.

**Ka kritikë që thonë edhe pse jemi në kuadrin e spekulimeve që ju mund të kërkoni nga Berisha pikërisht disa dikastere, apo ministri ku mundësia e korruptimit është shumë e madhe. Ju jeni në gjendje të sfidoni këta kritikë duke kërkuar ndoshta ministri ku kjo mundësi është shumë më e vogël?**

Këta kritikë janë nga ata të cilët janë vënë në shërbim të një projekti korruptiv të Ramaës për të korruptuar të gjithë shoqërinë shqiptare duke filluar që nga analistët, mediat e kështu me radhë. Ne hymë në këtë qeveri për të shpëtuar vendin nga një krizë. Ne hymë në këtë qeveri për të dhënë mesazhe stabiliteti dhe integrimi dhe padyshim hymë në këtë qeveri për një program transparent, i cili synon luftën kundër korrupsionit dhe pavarësinë e gjyqësorit. Këto nuk janë shqetësime të ndershme të analistëve, përkundrazi këto janë paragjykime që duan të kompleksojnë Ilir Metën dhe LSI në këtë hap historik që vë në rend të parë interesat kombëtare. Ndaj unë do t'i ftoja të gjithë ta monitorojnë qeverinë e re, koalicionin e ri dhe të na ndihmojnë me kritikat e tyre.




**Cili është mendimi juaj, përse në Shqipëri shikohet me kaq vështirësi një lëvizje e tillë politike?**

Kjo vjen jo vetëm për prapambetjen që ka një pjesë e politikës shqiptare, por mbi të gjitha ky është një dëshpërim që vjen nga dështimi i një përpjekje për të kontrolluar të gjitha pushtetet në Shqipëri. LSI nuk pranoj të bëhej pjesë e këtij kaosi, destabiliteti, por vendosi të hedhë një hap të rëndësishëm për stabilitetin e vendit, për qeverisjen e tij dhe për të vijuar integrimin evropian që është projekti kryesor i LSI-së. Ne na vjen shumë keq për shprehje të tilla të dëshpëruara pasi LSI nuk ka asnjë borxh ndaj PS, e cila u soll në mënyrën më armiqësore për gati 2 vite ndaj LSI, e cila realizoj një projekt mafioz për shkatërrimin e LSI-së në këto zgjedhje. LSI ka pozicionin e saj, ka votat e saj, çdo koalicion LSI–PS ishte i pamundur dhe vetëm sjell krizë. Kjo është zgjidhja që i shërben vendit dhe ne do të ngrihemi mbi interesat e pjesshme.

**Keni deklaruar më përpara se ju do jeni kryeministri që do ta fusni Shqipërinë në Evropë në 2013. Ky ishte basti juaj i fituar nga pjesëmarrja në qeverinë Berisha apo do bëni sërish kryeministrin për 2013?**

Kjo nuk është çështja më e rëndësishme. Natyrisht që unë do të kisha dëshiruar një rezultat shumë më të mirë edhe për LSI, edhe për Ilir Metën, edhe për të majtën në tërësi pavarësisht nga raportet tona me lidershipin aktual të PS. Megjithatë i gjithë lajtmotivi im në jetën politike është integrimi i Shqipërisë në Evropë. E rëndësishme është ky anëtarësim të realizohet sa më parë. Është apo jo Ilir Meta kryeministër, kjo është një çështje sekondare pavarësisht nga dëshira personale, por Ilir Meta gjithmonë është për integrimin evropian të Shqipërisë.

### Pas Konventës

## LSI përcakton objektivat për koalicionin e ardhshëm qeverisës

TIRANE - Kryetari të KDK-së, Edmond Haxhinasto e cilësoi dje vendimin e Konventës Kombëtare, për të marrë pjesë në qeverisjen e ardhshme të drejtuar nga kryeministri Sali Berisha, si një shembull i qartë i funksionimit të demokracisë së brendshme në Lëvizjen Socialiste për Integrim.

"Konventa ishte një shembull i qartë i funksionimit të demokracisë së brendshme në Lëvizjen Socialiste për Integrim dhe pasqyrë e hapësirave për shprehjen e mendimit ndryshe dhe për respektimin e tij", u shpreh Haxhinasot.

Ai vuri në dukje se Konventa e Jashtëzakonshme Kombëtare e LSI, miratoi një Rezolutë për pjesëmarrjen e LSI në bashkëqeverisje me Partinë Demokratike, si fituese e zgjedhjeve te 28 qershorit 2009, si dhe mandatoi Kryetarin e LSI, Ilir Meta të negociojë me Kryetarin e Partisë Demokratike për krijimin e koalicionit qeverisës.

"Konventa vlerësoi vendimin e LSI për pjesëmarrje në koalicionin qeverisës si alternativën e vetme për të garantuar stabilitet politik në vend dhe për të vazhduar proceset integruese", deklaroi kreu i KDK-së, Edmond Haxhinasto.

Sipas tij, "Konventa konkludoi se dalja nga kriza aktuale ekonomike, reformat e integrimit evropian, lëvizja e lirë e shqiptarëve në BE, reforma zgjedhore dhe pavarësia e gjyqësorit do të jenë objektiva kryesore edhe për koalicionin e ardhshëm qeverisës".

# Vera e kandidatëve të nxehtë

## Në sytë e ndërtimtarëve, tregtarëve, investitorëve në patundshmëri dhe mafinë ordinere, lufta për Prishtinën do të jetë betejë për sukses apo dështim

**Nga Petrit Selimi (Express)**

Ditët e korrikut po dergjen pa e vërejtur shumë zhegun e madh e të shumëpritur. Ishalla hiç nuk vjen kësaj vere, sepse vjeshtën edhe ashtu presim ta kemi te nxehtë. Gushti do të jetë muaj i vdekur, por tek ne rritjet e temperaturës shënohen në shtator, me sezonin e grevave.

Biznesmenët dhe distributorët e gjësendeve të konsumit të gjerë ka kohë që ankohen se nuk ka kesh në ekonomi. Edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar parashikon një rënie të të ardhurave nga remitencat - dërgesat monetare të kosovarëve emigrantë që ndihmojnë kushërinjtë e tyre në Kosovë. Mungesa eventuale e të ardhurave shtesë që i ndihmojnë kosovarët në përballim të gjendjes, përndryshe mizore ekonomike, do të hetohet pas muajve të verës dhe këtë vit stresi do të derdhet mu në muajt para zgjedhjeve komunale, në fund të nëntorit.

Në verën e lagur të 2009'it, peizazhi politik është mjaft i qartë. Në nivel kombëtar, gjërat pak a shumë janë stabilizuar. Gjysma e popullatës është e zhgënjyer tërësisht dhe nuk do të votojë fare. Në gjysmën tjetër që edhe voton herë pas here, PDK'ja ka shumicën stabile të votuesve të vetë, LDK'ja është në rënie të lehtë, apo ndoshta më mirë të themi - suspendim të rënies totale, AAK'ja ka ngritje të lehtë, Pacolli është aty ku ka qenë, të tjerët vështirë se kapërcejnë pragun në nivel kombëtar.

Por, relacionet mes partive në nivel kombëtar fshehin ca mikrofenomene paraelektorale në nivel lokal.

Sipas IKD'së, dhe rrëfimeve anekdotale që i dëgjojmë nga mysafirët dhe aktivistët e Prizrenit, kryetari i atjeshëm i Komunës nuk ka arritur ta konsolidojë fitoren e zgjedhjeve të kaluara dhe me gjasë do t'i humbasë zgjedhjet e sivjetme, pos nëse apatia qytetare në Prizren arrin nivelin e mospjesëmarrjes absolut në zgjedhje. Është ironike që Eqrem Kryeziu është njeriu më atraktiv për votuesit e Prizrenit.

Suhareka e afërt, bastion i hershëm dhe disa kanë besuar - i përjetshëm - i LDK'së, herën e kaluar për pak aprovoi thirrjen elektorale të PDK'së: "Bashohu edhe ti me ne". Enver Hoxhaj për një fije i humbi zgjedhjet dhe u bë ministër i Qeverisë, ndër më të mirët bile. Mirëpo, LDK nuk luftoi shumë për t'i konsoliduar radhët.

Ndoshta kalimet e disa anëtarëve të lartë të LDK'së në AAK nuk kanë qenë aq tragjike, por kjo nuk vlen për Suharekën. Blerim Kuçi, kandidati i AAK'së për kryetarllëk të saj, ka gjasa të shkaktojë një lëvizje të vockël tektonike. Suhareka ka fshatra që kanë pasur shumë luftëtarë në FARK dhe një pjesë e popullatës do ta shikon me simpati linjën konfrontuese që ka marrë udhëheqësia e AAK'së ndaj PDK'së.

Në Gjakovë, për të satën herë po përgatitet një iniciativë qytetare që synon ta prishë balancën midis LDK'së dhe AAK'së. Mendimet janë të ndara në dysh: ca thonë që Pal Lekaj ka arritur të mbajë Gjakovën, disa tjerë thonë se Gjakova do t'i kthehet LDK'së. E njëjta vlen edhe për Pejën. Liderët e LDK'së e konsiderojnë Pejën si "të kthyer", edhe pse bindje të tilla ata kanë pasur edhe për zgjedhje komëtare, për ta korrur në fund humbjen më të thellë politike të LDK'së në historinë e saj.

Ç'është e vërteta, e vetmja komunë ku LDK'ja i ka gjasat më të mëdha të mbajë pushtetin është margaritari i zgjedhjeve - Prishtina. Kryetari i ardhshëm i komunës më të pasur kosovare do të ekzekutojë plane dhe ligje sipas Ligjit të ri për Prishtinën, i cili përkundër zvarritjeve, pas zgjedhjeve do të aprovohet doemos. Ligji i jep autonomi të gjerë kryeqytetit dhe është platformë për ta bërë Komunën të jetë më afër qytetarëve në projekte dhe shërbime. Kjo e fundit natyrisht vlen vetëm në teori.

Në praktikë, Prishtina e fuqizuar do të ketë buxhet të fuqizuar dhe mundësi autonome të mbledhjes së të ardhurave tjera, me koncesione apo privatizim.

S'do mend se në sytë e ndërtimtarëve, tregtarëve, investitorëve në patundshmëri dhe mafinë ordinere, lufta për Prishtinën do të jetë betejë për sukses apo dështim.

Isa Mustafa nuk qëndron keq, sepse nuk ka kandidat të fortë nga oponentët. Kah fundi i mandatit filloi realizimin e ca projekteve që do t'i përdorë maksimalisht për fushatë, edhe pse është fare e qartë për qytetarët e Prishtinës se kualiteti i jetës në kryeqytet nuk është duke u përmirësuar. por duke u përkeqësuar.

Investimet që po bëhen shpesh janë të kualitetit të dyshimtë dhe ad hoc, pa ndonjë bazë. Plani Strategjik 2040, i bërë shpejt e shpejt, sot është i pazbatueshëm dhe jashtë asaj që ka ndodhë në terren.

"Planet e vogla", ato të mëhallëve, që është dashur të krijojnë rregull në lagjet e kryeqytetit, janë të pazbatueshme, sepse janë bërë keq, ose ëndërrimtare deri në pazbatueshmëri.

Këto janë problemet në perspektiven e zogut, pasi nëse e marrim perspektivën e bretkosës, e shohim që me të vërtetë jemi në një moçal urbanistik. Isa Mustafa duhet ta dijë: jetesa në Prishtinë nuk është e mirë, e shëndetshme dhe e rehatshme, dhe në këto kategori ai nuk ka sjellë ndonjë ndryshim.

Megjithatë, Mustafa ka arritur së paku të ruhet nga balta që e ka kapluar një pjesë të LDK'së dhe duket dinjitetshëm në sytë e shumë qytetarëve. Pos ndonjë favori të aty-këtushëm për miqtë, të cilët i ka pajisur me leje për të ndërtuar ndërtesa qesharakisht të jashtëligjshme, në kontekstin e akuzave që bëhen në skenën politike kosovare, Mustafa duket si engjëll.

Në sondazhet e ndryshme, Ministri i Arsimit Enver Hoxhaj qëndron lartë. Mirëpo, dyshoj se ai do ta rrezikojë dhe ta ndërpresë punën e bërë në arsim, për të luftuar për karrigen e kryeqytetit. PDK'së po i mbyllet dritarja e mundësisë për ta prezantuar një kandidat kredibil. Fytyrat më të popullarizuara nuk do të kandidohen, të tjerët Isa "i sosë", siç do të ishte shprehur Kodra e Trimave lëdëkëiste.

Dy kandidatë që mund të krijojnë opsion real për votuesit janë Behgjet Pacolli dhe Blerim Shala.

Pacolli ka armiq dhe skeptikë, por ka edhe përkrahës. Shumëkush do të besojë se Prishtina ka nevojë për një dorë të fortë, një pasanik të pashoq, që do ta realizonte ëndrrën e tij të vjetër për të udhëhequr e investuar në Kosovë. Por, nuk jam shumë i bindur se Pacolli e sheh veten si kryetar komune, rrethekuar me një milion e një probleme, prej gypave të kanalizimit deri tek çerdhet e fëmijëve. Përmendeni pozitën e Kryetarit të Shtetit, atëherë ndoshta do të zgjohet vëmendja e tij.

Blerim Shala mbetet në fund si një opsion që është ende enigmatik. Nuk e dimë nëse po e konsideron seriozisht kandidaturën apo bëhet fjalë për një spekulim të kotë. Ekspertët e sondazheve thonë ai se ka potencial elektoral në shumë shtresa, një parakusht për çfarëdo suksesi eventual. Ka të tillë që e shohin si personazh jo të zakonshëm në skenën politike. Gjatë vitit, Shala shkruan artikuj në tri gazeta të përditshme, shkruan raporte dhe projekte, fjalime dhe propozime, deri tek recensionet e rock albumeve dhe poezi. Nuk di nëse është kualitet i domosdoshëm për menaxhim të qytetit. Po ashtu, nuk di nëse do të arrijë t'i bindë qytetarët se lufta katërvjeçare me pushtetin qendror do të jetë e mirë për kryeqytetin.

Megjithatë, Blerim Shala mbetet opsioni i vetëm i këtij momenti për ta nxehur pak verën politike. Pos nëse dikush nuk ka ndonjë xhoker të fshehur mes letrash.

# Koment/Serbia është shumë larg denazifikimit që kërkon prej saj BE-ja

## Po të kishte pak drejtësi në këtë botë, Serbia do të duhej të ndëshkohej që për pesëdhjetëvjeçarin e ardhshëm të mos hynte në strukturat e BE-së, për faktin se 20 vjet me radhë prodhoi vetëm luftëra dhe kriza. Ajo, vetëm gjatë dhjetëvjetëshit të fundit të shekullit që kaloi, mori jetën e 300 mijë të pafajshmëve. Po ashtu, shumë nga kushtet e kërkuara nga vetë strukturat e BE-së, Serbia kurrë nuk i ka përmbushur.

**Nga Skënder Mulliqi**

Edhe më parë, Oli Rehn, po edhe së fundmi, minisitri i Jashtëm i Italisë, Franco Fratini, deklaruan se BE-ja, gjatë këtij viti, do ta bëjë liberalizimin e vizave fillimisht për Serbinë, gjë që është për t'u habitur shumë! Shqipëria dhe Kosova mendohet se vijnë disi më prapa... Nga strukturat relevante të BE-së, u paralajmërua se banorëve të Kosovës nuk do t'u pranohen pasaportat e reja serbe, nëse ata vendosin t'i marrin. Menjëherë bie në sy se shtetet për cilat bëhet fjalë, janë me shumicë me popullatë të përkatësisë sllave, ndërsa po anashkalohen dy shtetet shqiptare! Maqedonia mendoj se ka edhe shumë për të bërë, kur është fjala karshi të drejtave legjitime të shqiptarëve atje. Dihet se kjo republikë ende ka telashe me Greqinë, e cila nuk po e pranon emërtimin "Republika e Maqedonisë". Edhe Mali i Zi ende nuk i ka përbushur të gjitha kërkesat që u takojnë shqiptarëve në këtë republikë. Serbia, po të kishte pak drejtësi në këtë botë, do të duhej të ndëshkohej që për pesëdhjetëvjeçarin e ardhshëm të mos hynte në strukturat e BE-së, për faktin se 20 vjet me radhë prodhoi vetëm luftëra dhe kriza. Ajo, vetëm gjatë dhjetëvjetëshit të fundit të shekullit që kaloi, mori jetën e 300 mijë të pafajshmëve. Po ashtu, shumë nga kushtet e kërkuara nga vetë strukturat e BE-së, Serbia kurrë nuk i ka përmbushur. Denazifikimi i saj as që ka filluar. Ajo e bëri dorëzimin e disa kriminelëve të luftës, vetëm atëherë kur përfitoi politikisht prej tyre. Në vend që të dënohet për gjenocid, Serbia e Tadiqit u faktorizua në raport me të ardhmen e Kosovës. Vendi ynë, për çudi, duhet ta mbrojë legjitimitetin e shpalljes së pavarësisë para GJND-së!!!

Për nëntë vjet me radhë, Serbia arriti ta zvarrisë definimin e statusit politik të Kosovës. Për dy vjet radhazi, Grupi i Unitetit u detyrua, pikërisht nën trysninë e BE-së, të zhvillojnë dy vjet bisedime në Vjenë, të cilat rezultuan pa ndonjë efekt, kur paraprakisht dihej qëndrimi shovinist i Beogradit zyrtar karshi Kosovës. Presidenti serb, Boris Tadiq, i cili po përkëdhelet nga Evropa, disa herë radhazi, edhe para burrështetasve më të mëdhenj botërorë, deklaroi se kurrë nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës. Një qëndrim i tillë dualist i BE-së nuk justifikohet me asgjë. Me fajin e Serbisë dhe të bashkësisë ndërkombëtare ende po funksionojnë strukturat kriminale ilegale serbe brenda territorit të një shteti ndërkombëtarisht të pranuar. Dhe dikush nga shtetet e BE-së, të cilat edhe e kanë pranuar pavarësinë e Kosovës, është i intersuar që veriu i Mitrovicës të bëhet pjesë e Serbisë. Thënë shkurt: Serbia ishte dhe ka mbetur një shtet, i cili kontrollohet nga kriminelët e të gjitha ngjyrave. Lufta kundër krimit të organizuar, zatën edhe është njëri nga kushtet kryesore për anëtarsim në strukturat e BE-së. Me këtë rast, BE-ja, me të dyja këmbët, po i shkel parimet veta. Të gjitha këto fakte, dhe shumë të tjera, të cilat nuk janë përmendur në këtë shkrim, flasin se Serbia me kurrgjë nuk e ka merituar që të përfshihet në liberalizimin e vizave, të paktën para dy shteteve shqiptare të Ballkanit. Aq më tepër habit fakti se si bën që një anëtare e NATO-s, siç është Shqipëria, të mos përfshihet në planin e parë të liberalizimit të vizave, para të gjitha shteteve të tjera të Ballkanit Perëndimor?! Po ashtu, është absurde edhe mospërfshirja e Kosovës, kur dihet se shumë forca evropiane, duke e përfshirë edhe EULEX-n, gjenden brenda territorit të Kosovës. Thjesht, Serbisë, një shteti ende me matricë naziste pa kurrfarë merite, po i bëhet një dhuratë që s'e meriton.

# “Busy” intelektualët e rinj

**Nga Anton Marku**

Besoj se roli i të shkolluarit dhe intelektualit është që në radhë të parë t’i shërbejë njerëzve dhe komunitetit të tij. Kjo zaten edhe pritet prej tyre. Por, kohëve të fundit, është përshtypje e përgjithshme se shoqëria, në masë të madhe, po “prodhon” edhe disa lloje të çuditshme të intelektualëve të rinj, saqë koha për ta është ende term relativ. Nuk mbajnë me vete as orë dore, as xhepi, dhe thonë se janë aq të zënë-shumë të zënë ...me çka, e dinë vetëm ata.

B. e takova në kryeqytetin e një shteti evropian. Ishte në përfundim të doktoraturës dhe bënte plane të mëdha për karrierë. Reflektuam së bashku lidhur me faktin se diaspora jonë ishte shumë e dezorientuar dhe se kishte nevojë për një formë të re organizimi. Nuk jam prej atyre që kërkojnë që rrugëve të Evropës të endemi me plisa të bardhë në kokë dhe me Kur’an apo Bibël nën sqetull. Por, integrimi në shoqëritë vendase nuk do të thotë të heqësh dorë nga identiteti yt kolektiv dhe personal. Të bëhesh dikush që nuk je. Edhe pse pajtohej me pothuajse të gjitha mendimet e mia, dikur me tha: “le të lemë njerëzit të bëjnë ashtu si duan. Pse të merremi me ta. Le të punoj secili për vete. Ja unë për shembull jam shumë i zënë. Koha për mua është ar. Dhe më shumë se kaq”. U lavdërua se boton shkrime në gjuhë të huaja. Në gjuhën shqipe nuk kishte shkruar as dhe një rresht të vetëm. “Artikujt e mi janë të rëndë për lexuesin shqiptar” ishte arsyetimi i tij. Duke dashur që ai të mos ,,humb” shumë kohë në këto angazhime ,,diasporale”, i propozova që për të mirën e përbashkët të ndajë vetëm nga një orë në muaj, duke llogaritur nga dy minuta në ditë, aq sa zgjat publikimi i një blloku reklamash në TV. Asgjë më shumë. E lashë pas vetes ,,intelektualucin” tonë që në qetësi të shkruaj enciklopedinë e karrierës dhe xhepit të vet personal. Ka tre muaj që pres të dëgjoj ndonjë lajm nga ai.

D. sapo kishte përfunduar me nota shumë të larta fakultetin e shkencave politike në Prishtinë. Që në njohjen e parë u presantua si politolog. Më erdhi mirë dhe e pyeta për angazhimin e tij në politikë. Më ,,sqaroi” se profesioni i tij është të analizojë proceset politike, por jo domosdoshmërisht dhe që të jetë politikisht aktiv. Lidhur me zgjedhjet e ardhshme lokale kishte opinion refuzues, duke mbrojtur qëndrimin se kosovarët duhet bojkotuar ato. Argumentet për këtë i kishte shumë të brishta. E sfidova duke i sugjeruar që mendimet e tij t’i ndante me të tjerët, dhe atë në formë të një artikulli që do ta dërgonte për botim në ndonjë nga gazetat vendore. Pranoi duke më premtuar se paraprakisht do të më dërgoj versionin e parë të tij. Dhe e bëri atë. Në 24 rreshta shkrim kishte më shumë se 50 gabime drejtshkrimore. Me cinizëm u arsyetua se nuk kishte studiuar gjuhën shqipe, por diçka tjetër. Thuajse në shoqërinë tonë vetëm gjuhëtarët duhet të dijnë të shkruajnë shqip. Më premtoi se do të përmirësoj shkrimin dhe të më dërgoj verzionin e dytë. Ka një kohë të gjatë që po pres atë shkrim, por deri tani nuk më erdhi gjë.

Prototipi i tretë është I. Ai është para diplomimit. Lexon shumë dhe shikon mjaft filma. Në bisedë me të kuptova dëshpërimin e tij më të fundit. Tregoi se si para disa muajve forumi rinor i njërës nga partitë tona politike i kishte dërguar ftesë për pjesëmarrje në kuvendin e saj zgjedhor. Duket se njëri nga organizatorët, në shaka, i kishte premtuar se emri i tij do të jetë në mesin e 15 anëtarëve të kryesisë që pritej të përzgjidhej. Edhe pse me shumë angazhime tjera anësore, kjo e kishte gëzuar aq shume saqë kishte njoftuar të gjithë të njohurit se po bëhej ,,diçka i madh”. Çka nuk e dinte as vete. Ditën e caktuar kishte ardhur ndër të parët në vendin ku pritej të mbahej kuvendi. Në hyrje, kishte vërejtur një listë me 15 emrat e kandidatëve të propozuar për postet e parashikuara. Në mesin e tyre nuk figuronte emri i tij. Nga inati dhe hidhërimi ishte larguar nga aty, për të mos u kthyer më. Edhe pse e pranoj se kurrë më parë nuk kishte marrë pjesë në ndonjë organizim politik, e vetmja mënyrë e ,,aktivizimit” të potencialeve të tij ,,intelektuale” ishte që po ajo parti t’i kërkoj falje publike për dëmin shkaktuar ,,reputacionit” të tij dhe karrierës që po planifikonte të ndërtonte. Kaq i ngushtë ishte diapazoni i tij. U largova edhe nga ky ,,intelektualuc”. Dëgjoj se ende shikon me po aq pasion filmat e vizatuar. Ashtu si kur ishte vet fëmijë. Para njëzet e sa viteve.

# Vetëpërjashtimi si flijim absurd

**Nga Shaip Beqiri**

Rrethanat në të cilat u bë përcopëzimi dhe përçarja e mërgatës shqiptare në organizimin e saj ndër parti politike në fillim ndoshta edhe mund të kuptohej si një solidarizim euforik dhe identifikim në largesë me organizimin që nisi të bëhej në vend, por vazhdimi i saj kaq këmbëngulës për të mbetur e pandryshuar kjo formë e organizimit të saj është një çudi që vështirë mund të kuptohet dhe pothuaj e pamundur të shpjegohet. Nën trysninë e madhe të rrezikut të përndjekjes së përhershme, të deri vonë e ndjenin njësoj si në vend ashtu edhe në dhe të huaj, mërgimtarët tanë u organizuan pa u hamendur aspak ndër parti politike shëmbëllyeshëm siç ishin ato brenda vendit. Në atë kohë kjo mund të luante një rol në afrimin dhe bashkimin e tyre sidomos përsa i takon lidhjes së drejtpërdrejtë me të gjitha çështjet preokupuese të atëhershme në vend. Mirëpo është e çuditshme që këtë lloj organizimi e bënë vetëm mërgimtarët tanë nga Kosova dhe viset e tjera jashta Shqipërisë. Thashë që ishte deri diku e kuptueshme kjo gjë, por njëherësh edhe krejtësisht e jashtëkohshme dhe absurde. Ndërkaq ky organizim partiak shpejt do të kthehej në një bumerang tepër të rrezikshëm me goditje të gjerë e të fortë përsa u përket mundësive të pashtershme të manipulimit dhe të përçarjes që vazhdoi të thellohej pandalshëm në vijë të veprimit të tërësishëm kombëtar. Amëzat në vend të këtyre partive politike dhe grupimeve të tjera partiake në mërgatë kishin interes praktik që këto dega e degëza t‘i mbanin në mbikëqyrje si një logjistikë të nevojave të veta, por sidomos për burim të ardhurash në dorë e pas dore; kurse vetë ato bëheshin se po luanin një rol të rëndësishëm në çështjen e madhe kombëtare, duke i derdhur në çdo anë vërshueshëm frustrimet e tyre për dalje nga zhgualli i ntrashur i inferioritetit dhe anonimatit. E vetmja gjë “harmonike” ishte përqendruar në këtë pikë. Në anën tjetër, pikërisht këta veprimtarë që ishin strehuar ndër organizime partiake për të dalë papritur në krye të tyre, do të pengojnë gjithmonë çdo përpjekje për ndonjë lloj organizimi me bazë kombëtare të mërgatës shqiptare. Ata ishin pozicionuar lehtësisht në krye të këtyre formave të bashkimit, të cilat rriteshin nga dita në ditë me shpejtësi të madhe, pa dhënë pothuaj kurrfarë provash dhe pa përmbushur asnjë kriter përzgjedhës të konkurrencës së lirë, duke përftuar njëkohësisht një shtresim meritash pas të cilave truma e madhe e karrieristëve do të ngjitet pashkëputshëm deri në varr! Është e padrejtë të thuhet se të gjithë ishin njësoj karrieristë të frustruar, që dobitë e tyre i mbulonin gjoja me bindje e ide politike, shpesh duke shkuar deri në fanatizëm. Ndër ta ka pasur gjithnjë edhe veprimtarë të palodhshëm, të gatshëm të bëjnë çdo sakrificë për të mirën e kombit dhe atdheut, gjë që jo rrallë e kanë provuar konkretisht, por, sidoqoftë, veprimi i tyre me ngjyrim partiak, aq më parë në dhe të huaj, ua ka zbehur së tepërmi profilin moral dhe ua ka bërë të shurdhër zërin kundruall trumave të karrieristëve me etje të pashuar për t‘u dukur në krye të tribunave…

Fakti që ky organizim i mërgatërs vazhdoi herë më me vrull e herë si i mosqenë edhe në kohën e pasluftës, e bën të patundur idenë për dëmin që e bëri ai shumëfish më të madh se ndonjë dobi eventuale që do të ketë mundur të sjellë. Ndonëse u paraqitën shumë heret disa përpjekje të vogla për një organizim të qenësishëm me bazament kombëtar të mërgatës shqiptare, ato u tretën si vesa para diellit para synimit të prapaskave të kurdisura për t‘i mbajtur këta njerëz përgjithmonë të shpërndarë, të ndarë e përçarë jo rrallë deri në armiqësi të kota. Ç‘është e vërteta, këtë farë të përçarjes e kishin lënë trashëgim të keq organizimet e hershme ilegale të grupeve të ideologjizuara të mërgatës sonë, kurse shpërndarja e re ndër parti politike ishte një përgjigjie disi e vonuar dhe tepër e mjerë e një grushti njerëzish të tjerë apo të njëjtë, të cilët bënë këtë manipulim të madh për të dëftuar se ishin diku dhe nuk duhej kaluar në heshtje pranë tyre.

Mbetja e shqiptarëve ende në këtë formë organizimi kaq të prapambetur në fillim të këtij mileniumi në Europën që synon intergimin me vlera tepër të larta të qytetërimit modern, duke lënë prapa të mbuluara përgjithmonë edhe vetë ajo jo pak të palara të vetat të tmerrshme, është një shkak tepër i madh që dëfton thelbësisht gjendjen e mospërfaqësimit të një mase kaq të madhe shqiptarësh në asnjë listë të të drejtave themelore qytetare: e drejta të zgjedhësh dhe jesh i zgjedhur!

**“Bota sot”**

# Përcillet në banesën e fundit mjeku Beniamin Çetta, "qytetar nderi" i Durrësit



Qindra qytetarë durrsakë përcollën dje me nderime në banesën e fundit mjekun e njohur kardiolog, Beniamin Çeta, që vdiq të martën në moshën 72-vjeçare pas një sëmundjeje të rëndë. Homazhet në nderim të Çettës u bënë në hollin e pallatit të kulturës "Aleksandër Moisiu" të qytetit të Durrësit, ku nderuan drejtues të pushtetit vendor, deputetë e politikanë, mjekë, artistë e sportistë dhe bashkëqytetarë të shumtë. Dr. Beniamin Çeta në 5 dekadat e punës hyri si mjek në gjithë shtëpitë e durrsakëve, duke fituar admirimin e bashkëqytetarëve për punën e përkushtuar dhe duke pranuar si shpërblim të vetëm, respektin e pamatë të tyre. Ai gëzon respektin e kolegëve mjekë, që vlerësojnë bagazhin shkencor dhe aftësitë e tij deri në çastet e fundit të jetës. Dr.Beniamin Çetta lindi më 21.03.1937 në Tiranë, ku i jati, Lazër Çeta punonte si nëpunës, që qeveria franceze e kishte dekoruar me titullin e lartë të Legjionit të Nderit. I vëllai i Dr. Beniamin Çettës, Prof. Anton Çetta është personaliteti i njohur i viteve 1980 si nismëtar i pajtimit të gjaqeve në Kosovë. Beniamin Çetta kreu shkollën fillore e të mesme në Durrës dhe në periudhën 1954-1959 studjoi në degën e mjekësisë së Universitetit të Tiranës. Në vitin 1960 u specializua për kardiologji dhe pasi punhoi për 1 vit si mjek në Rrogozhinë, në periudhën 1960-1981 punoi si mjek Durrës, ku si i vetmi kardiolog i asaj kohe, përballoi një volum shumë të madh pune jo vetëm në poliklinikë, por dhe në banesë.

Në vitin 1981 u arrestua dhe u dënua me 10 vjet heqje lirie, sipas nenit famëkeq 55 "Per agjitacion e propagandë" ku dënimin e kreu në burgjet e Bulqizës, Qafë-Barit dhe Zejmenit. Pasi u lirua nga burgu në 1986, punoi si mjek i përgjithshëm në fshatin Lekaj, ndërsa në vitet 90-92 punon si kardiolog në poliklinikën e qytetit të Durrësit. Në vitin 1992 del në pension, por megjithatë vazhdoi të vizitojë dhe të ndjekë ecurinë e dhjetra pacientëve që kishin besim në njohuritë dhe përkushtimin e tij. Përveç punës së përditshme si mjek, Dr. Beniamin Çetta është aktivizuar në shoqatën humanitare Caritas dhe komunitetin e personave me probleme të drogës, Emanuel. Në tetor 2008 Dr. Beniamin Çetta u shpall "Qytetar nderi" i Durrësit, me motivacion "Për merita të veçanta në shërbim të komunitetit dhe kontributin e dhënë në fushën e kardiologjisë". Dr. Beniamin Çeta gjatë gjithë jetës u shqua për humanizmin dhe sakrificat e jashtëzakonshme në shërbim të pacientëve dhe qytetarëve jo vetëm të Durrësit, por nga i gjithë vendi. Megjithëse pas vdekjes së nënës së tij jetoi thuajse vetëm, dr. B. Çetta ishte një nga figurat më të dashura të qytetit të Durrësit, që e përcolli sot si bir të shtrenjtë.

## Papa uron që enciklika e re ta ndihmojë njerëzimin që të ndjehet një familje e vetme

Benedikti XVI dje paradite gjatë audiencës së përgjithshme ka uruar që enciklika e tij e re 'Caritas in Veritate' – ' E Vërteta me Dashuri' e botuar dje, "ta ndihmojë njerëzimin të ndjehet një familje e vetme, e impenjuar në realizimin e një bote të bazuar në drejtësi e paqe". "Jo vetëm me të mirën materiale" por sidomos me "rritjen shpirtërore" realizohet zhvillimi i plotë i personit njerëzor, tha Ati i Shenjtë Racinger. "Të lutemi që enciklika e re të mund të ndihmojë njerëzimin të ndjehet një familje e vetme" e, shtoi, "të lutemi që besimtarët që veprojnë në ekonomi e në politikë ta ndjejnë se sa rëndësishme është dëshmia e tyre ungjillore".

**Benedikti XVI dhe kryeministri i Japonisë shkëmbejnë pikëpamje për krizën ekonomike botërore**/Gjendja e shkaktuar nga kriza ekonomike dhe impenjimi i Japonisë e Selisë së Shenjtë për Afrikën, kanë karakterizuar dje paradite audiencën e Benediktit XVI me kryeministrin e Japonisë, Taro Aso, i cili vizitoi Vatikanit bashkë me bashkëshorten e delegacionin përcjellës. Pas bisedimeve me Papën, njofton një deklaratë zyrtare e Vatikanit, kryeministri i Japonisë është takuar edhe kardinalin sekretar të Shtetit të Selisë së Shenjtë, Tarçizio Bertone, dhe me sekretarin për Marrëdhëniet me Shtetet, kryeipeshkvin Dominique Mamberti. "Lidhur me planin bilateral – përfundon deklarata e Sekretarisë së Shtetit të Vatikanit – janë përmendur marrëdhëniet e mira ndërmjet Japonisë e Selisë së Shenjtë, si dhe mirëkuptimi e bashkëpunimi ndërmjet Kishës e Shtetit në Japoni".

**Me 8 korrik shënohet përvjetori i vdekjes së imzot Lazër Mjeda**/Duke shfletuar kalendarin historik, më 8 korrik shënohet përvjetori e vdekjes së kryeipeshkvit shqiptar të Shkodrës imzot Lazer Mjedjes.

Lazer Mjeda, lindi në Shkodër në një familje shumë të varfër, me 6 mars të vitit 1869, ndërsa vdiq më 8 korrik të vitit 1935. Imzot Laze Mjedja kryeipeshkëv metropolit i Shkodrës, ka qenë ipeshkëv edhe në dioqezën e Sapës, kryeipeshkëv i dioqezës së Shkupit. Luftëtar i pathyeshëm për të drejtat e fesë, atdhetar i flaktë e veprues i panjollë, punëtor i vlefshëm i gjuhës e këshilltar dhe mbrojtës i shndritur, ndihmëtar zemërgjerë i letërsisë kombëtare, themelues e kryetar i shoqnis letrare "Agimi" dhe i shqns botuese Jernyme. Me 6 gusht të vitit 1891 u shugurua meshtar në kapelën e Seminarit Papnor të Shkodrës; shërbeu si famullitar në Plan, Pog e Mëgullë në Pult. Bortoi vjersha që këndohen ende sot nga fshtararët vendas. Me 20 janar të vitit 1901 u shugurua ipeshkëv i Sapës dhe qe ndër ma të rinjtë nga mosha. Si ipeshkëv ndërtoi shumë struktura kishtare si dhe krijoi e ndërtoi shkolla, si: në Dajç, ku mësoi për do kohë vëllai i tij Dom Ndre Mjeda, i cili administronte atë famulli kishtar; pastaj shkollën e Hajmelit të Iballës. Së bashku me të vëllain dom Ndreun krijoi Shoqninë Letrare "Agimi" e cila botoi tekstet shkollore të asaj kohe. Më 1905 qe emëruar si ndihmës i ipeshkvit Imzot Guerinit dhe si i tillë rrethoi me mure e parmakë hekurit oborrin e Katedrales dhe ndërtoi rreshtin e dyqaneve në pjesën jugperëndimore të oborrit, si dhe plotësoi kullën e kishës.

Gjatë kësaj periudhe shoqnitë letrare janë në lulëzim të plotë. Më 1909 qe emërua Arqipeshkëv i Shkupit ku hapi shumë shkolla nëpër fshatra dhe punoi për lulëzimin e fesë e të kulturës në atë krahinë; ngriti struktura kishtare e i pasuroi, si dhe zbukuroi Kishën Katedrale të Prizrenit të Zojës Ndihmatre. Në Shkup ndërtoi selinë arqipeshkvnore dhe shtëpinë e Kishës famullitare. Më 1922 erdhi Arqipeshkëv i Shkodrës ku u vu menjëherë në punë për të përmirësuar dhe pasuruar Kishën e shtëpitë famullitare dhe nisi ndërtimin e kishës së Rusit. Stolisi kapelën e Arqipeshkvisë, në formë artistike, nën drejtimin e artistit Kolë Idromeno, i cili me duart e veta goditi Elterin.

Themeloi Fletoren e Klerit Katolik dhe Fletoren e së dielës, botoi librin "Rruga e Shelbimit" dhe me 19 mars1923 bekoi kumbonët e reja të Kishës Katedrale. Me 4 gusht 1929 shuguroi ipeshkëv Imzot Pjetër Gjurën Arqipeshkëv të Durrësit dhe Imzot Frano Gjinin ipeshkëv Abat të Mirditës në shtator të vitit 1930. Vdiq me 8 korrik 1935 e funerali qe nder ma të madhështorët që iu banë Arqipeshkvijve. Me 1926 pati kremtuar 25- vjetorin e ipeshkvisë.

*Marrë nga Radio Vatikani*

## Fiton ajo që na bën të mos konsumojmë mallra serbe

Ishte një lajm para do ditëve që entuziazmoi ata që presin funksionimin e Policisë së Kosovës në të gjitha "pikat" ku deri sot lirshëm është shkelur sovraniteti i Kosovës. Lajmi bën një konsum njëditor të fitores dhe suksesit në paraqitjen e fuqisë së vendosjes pushtetare të shtetit të Kosovës. Në fakt, nuk kalon asnjë ditë dhe deklaratat e ndryshme të zëdhënësve të organizatave ndërkombëtare në Kosovë, përsëri caktojnë "tajmautët" e ndryshëm ku do të pushojë status quoja e proklamuar e sigurisë së Kosovës me kufijtë e thyer nga ata që nuk e pranojnë. Jo lajmi i këtyre ditëve, po ka gati dhjetë vjet që në kufi (Bllace) nuk ke mundur të kalosh pa respektuar procedurat normale të ligjeve në fuqi (edhe pse ato ende nuk kanë qenë të kushtetutizuara deri më 15 qershor '08). Por derisa në Bllace, ose në pika të tjera kufitare (me Shqipërinë) është ndjekur dhe respektuar procedura ligjore e qarkullimit të ideve politike, në të gjithë vijën kufitare në veri të Kosovës, dhe jo vetëm në pikat doganore, qarkullimi ka qenë i lirë, por jo për "ide politike" por për mallra të kontrabanduar që për çdo vit e kanë dëmtuar ekonominë e Kosovës për një miliardë e katërqind milionë euro. Pra sukses do të ishte sikur të mund t'i ndalonim qarkullimet e lira të mallrave të kontrabanduara, por edhe atyre që futën legalisht të padoganuara, e jo individët që po të donin vërtet të futeshin në Kosovë, i kanë pasur qindra mënyra që kjo të mos bëhet hyrje ose ndalesë propagandistike politike. Ndërkaq, që sa kohë kaloi, gati që nëntë muaj që ka dalë në diskutim "zyrtar" publicistik dukuria (fenomeni) i thyerjes së kufirit nga mallrat e shtetit terrorist të Serbisë dhe është paraqitur në diskutim se kjo ka qenë dhe ka mbetur mënyra ekstreme e kolonizimi të Kosovës. Pse as opozita, as pozita, madje as qytetarët nuk bëjnë asgjë që të ndalohet ky eksport serb, po trumbetohet një ndalesë në jug, derisa në veri as nuk ka policë që kontrollojnë hyrje-daljet, qarkullimet e ideve dhe mallrave serbe?! A ka kush ngrihet dhe të bëjë një anatemë "opozitës" inekzistente që këtë shkretërim të Kosovës përpiqet t'ia ngarkojë Qeverisë, derisa vetë nuk bën asgjë që së paku anëtarët e partive të saj (opozitare) t'i udhëzojë që të mos i konsumojnë mallrat e Serbisë. Në pushtet do të vijë ajo parti politike e cila e para do t'ia dalë ta indoktrinojë popullin e Kosovës mos të konsumojë asnjë fije a kilogram mall serb që edhe mund të jetë i kontaminuar dhe në një kohë pak më të largët do ta ketë shkatërruar edhe shëndetin fizik, pos këtij shëndetit moral të shkatërruar që ka ndërgjegje të hajë bukë serbe.

### Trupi gjykues redukton aktakuzën kundër „Grupit të Llapit“

*Dje në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, ka nisur procesi i rigjykimit të tre ish- luftëtarëve të UÇK-së, Rrustem Mustafa, Latif Gashi dhe Nazif Mehmeti, të cilët akuzohen për keqtrajtim, rrahje dhe torturim të popullatës civile në qendrat e paraburgimit në Llapashticë, Koliq dhe Bajgorë. Nga aktakuza është hequr akuza për vrasje të civilëve. Kolegji i gjyqtarëve ka vendosë që ky proces të ngarkohet me aktakuzën e 30 qershorit të viti 2003. Kjo akuzë është reduktuar sipas së cilës trupi gjykues konsideron që kanë mbetur dhe do të procedohet pjesërisht pika 5, 8, 9 dhe 14-të e aktakuzës, tha avokati mbrojtës i Latif Gashit, Mexhid Syla. „Sipas këtyre pikave ngarkohen për trajtim mbajtje në kushte jo humane dhe jo njerëzore dhe torturë“, ka sqaruar avokati Syla. I akuzuari Latif Gashi, ka paraqitur mbrojtjen para gjyqtarëve. Ai ka parafrazuar mbrojtjen e tij të mëparshme duke thënë se ndihet i pafajshëm për akuzat me të cilat ngarkohet nga trupi gjykues. Mexhid Syla, avokat mbrojtës i të akuzuarit Latif Gashi, tha se trupi gjykues duhet të hedhë poshtë edhe këto pika me të cilat ngarkohen të akuzuarit, sepse nuk ka prova që mbështesin dyshimin se të akuzuarit i kanë kryer veprat penale me të cilat ngarkohen. Sot para trupit gjykues pritet të dëshmojnë, Rrustem Mustafa dhe Nazif Mehmeti.*

### Ministri Limaj priti drejtorin e e aviokompanisë gjermane „Air Berlin“, Joakim Hunold

*Qeveria e Kosovës, përmes infrastrukturës ligjore dhe investimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, ka ndikuar që ai të bëhet shumë tërheqës edhe për operimin e kompanive të huaja, ka thënë ministri i Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, Fatmir Limaj, pas takimit me drejtorin e aviokompanisë gjermane „Air Berlin“, Joakim Hunold, ku ishte i pranishëm edhe Ambasadori gjerman në Prishtinë, Hans Diter Shtajnbah. Ministri i Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, Fatmir Limaj, tha se angazhimi i qeverisë në avancimin e legjislacionit të aviacionit civil, puna në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës dhe infrastruktura ka ndikuar në zgjerimin e bashkëpunimit të Kosovës me vendet tjera dhe kompanitë e njohura. „Kjo do të thotë se Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës shumë atraktiv regjional, po kthehet në atraksion edhe për kompanitë e fuqishme që tani e tutje do t'i kemi partnerë dhe do të krijojë lehtësi edhe në qarkullimin e njerëzve dhe mallrave, dhe të gjithë atyre që janë të interesuar të vizitojnë Kosovën dhe qytetarëve tanë që qarkullojnë nga vende të ndryshme të Evropës“, ka theksuar ministri Limaj. Aviokompania gjermane „Air Berlin“ e ka vazhduar kontratën me kompaninë „Kosova Airlines“ dhe do të operojë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës edhe një vit. Drejtori i kësaj aviokompanie, Joakim Hunold, tha se për ndërtimin dhe zhvillimin e një vendi të ri siç është Kosova, është e rëndësishme të krijohen lidhje me vendet e zhvilluara, dhe në këtë drejtim kompania „Air Berlin“ dëshiron të japë kontributin e saj që Kosova të lidhet me vendet e tjera të botës. „Na vjen shumë mirë që ministria e këtushme ka bërë investimet e duhura në mënyrë që edhe aeroporti i Prishtinës t'i plotësojë standardet evropiane, sidomos investimet në sistemin e aterrimit, pasi kjo u mundëson aeroplanëve aterrim më të lehtë dhe fluturim nga këtu për në vendet e Evropës“, ka thënë z. Hunold.*

# Kosova arrin njohjen e 61-të, priten të tjera nga bota arabe dhe Amerika Latine

**Jordania ka konfirmuar dje edhe zyrtarisht njohjen e pavarësisë së Kosovës, duke u bërë kështu shteti i katërt arab që e kryen këtë hap diplomatik. Shpresa për efekt domino jo vetëm në Lindjen e Mesme, por edhe në Amerikën Latine e Afrikë, veçanërisht në ato zona ku ndikimi amerikan dhe ai britanik është më i madh**

Jordania ka konfirmuar njohjen e Kosovës. Kabineti qeveritar i këtij vendi, në një kumtesë të shkurtër, ka bërë të ditur se „Mbretëria Hashemite e Jordanisë njeh Republikën e Kosovës“. Mbretëria e Jordanisë ka konfirmuar njohjen e Kosovës, por për këtë ende nuk është njoftuar zyrtarisht Ministria e Jashtme e Kosovës. Zëdhënësja e ministrit të Jashtëm, Albana Beqiri, thotë se lobimi për njohjet e reja zhvillohet në vazhdimësi, por për shkak të korrektësisë ndaj vendeve që janë në proces të njohjeve, paralajmërimet për këto njohje nuk bëhen publike pa konfirmime zyrtare.



Në rastin e Jordanisë, Beqiri thotë se gjithçka ka përfunduar për kah ana politike e marrjes së vendimit dhe pritet vetëm shpallja publike e këtij vendimi. „Ne vazhdimisht flasim për sinjale, por asnjëherë për njohje deri në momente kur njohja të ndodhë zyrtarisht. Ne në kanale diplomatike jemi të informuar me njohjen, por presim nga momenti në moment të na vijë zyrtarisht letra e njohjes, që ta bëjmë edhe njoftimin publik për njohjen, edhe pse Jordania në të vërtetë është vendi i 61 që e ka njohur Kosovën“, thotë Beqiri. Sipas zëdhënëses Beqiri, njohjet e Kosovës do të vazhdojnë jo vetëm nga vendet e botës islamike e arabe, por edhe nga vende të Amerikës Latine e kontinente tjera. Beqiri thotë se Ministria e Jashtme është e angazhuar në kapacitete të plota që bashkë me mbështetësit ndërkombëtarë të sigurojnë numër sa më të madh njohjesh. „Është e vërtetë që Kosovës i ngutet dhe është e vërtetë që Ministria e Punëve të Jashtme, ashtu si gjithë Qeveria, institucionet dhe i gjithë populli i Kosovës, është e interesuar më së shumti që të këtë njohje, sa më të shpejta“. „Por, në fund të fundit, vendimin e marrin vendet, të cilat duhet ta bëjnë hapin për ta njohur Kosovën. Kemi sinjale të forta; ajo që mund ta konfirmoj zyrtarisht në emër të MPJ-së, është se sinjalet janë të vazhdueshme“, thekson Beqiri. Kosovën, si shtet të pavarur e sovran e kanë njohur tashmë 61 vende, përfshirë aty edhe Jordaninë. Pritjet e lidershipit në Kosovë janë që procesi i njohjeve të përfshijë edhe vendet e Amerikës Qendrore dhe Latine.

Ndërkaq, si më problematike paraqitet çështja e njohjes së Kosovës nga pesë vende të BE-së, të cilat në një masë njohjen e Kosovës e kanë ndërlidhur me procesin e interpretimit legal të shpalljes së pavarësisë së Kosovës nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.

# Presioni i zgjedhjeve vendore po shtyn LDK-në dhe LDD-në të shqyrtojnë opcionin e bashkimit

***Opsioni i bashkimit të LDK-së dhe LDD-së po shtrohet sërish. Nënkryetarët e këtyre partive, Lutfi Haziri dhe Berim Ramosaj, publikisht, janë shprehur në favor të bashkimit. Por, a ka gjasë vërtet të ndodhë një bashkim mes këtyre subjekteve? Në radhë të parë duhet të sqarohet se kush kujt do t'i bashkohet. Në radhë të dytë kush do ta marrë përgjegjësinë për ndarjen e këtyre subjekteve tri vjet më parë. A do të munden Fatmir Sejdiu dhe Nexhat Daci ta tejkalojnë vetveten?***

Në Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe në Lidhjen Demokratike të Dardanisë po shtohen zërat që thërrasin për një bashkim mes këtyre subjekteve, për të qenë grusht relevant përballë partive tjera. Nënkryetari i LDD-së, Berim Ramosaj, është profili më i lartë i këtyre subjekteve që ka bërë thirrje të hapur për bashkimin e partive të ndara në dhjetor të vitit 2006, pas Kuvendit të dhunshëm zgjedhor, që çoi më pas në fitoren e PDK-së në zgjedhjet parlamentare. Duke folur të hënën në mbrëmje në emisionin „Zona B“ të televizionit KlanKosova, Ramosaj ka thënë se elektorati i të dy partive si dhe një pjesë e madhe e anëtarësisë përkrahin bashkimin e LDK'së dhe LDD'së në një parti. „Për mendimin tim në vijë të ndalimit të këtij bashkimi janë një pjesë e liderëve të të dyjave. As LDK as LDD kështu si janë kurrë nuk do të mund të fitojnë më shumë ndonëse mund të ruajnë këto pozita. Kosova ka nevojë për një parti ku do të vihej besimi i shumicës së popullit“, ka thënë Ramosaj. Ai është shprehur i pakënaqur me qëndrimet e LDD-së si opozitë jo shumë aktive, por ka thënë se edhe Qeveria e Kosovës dominohet nga PDK dhe jo LDK. Ramosaj nuk është i vetëm në këtë kauzë. Nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri ka thënë se koha po vjen për bashkimin e këtyre partive, të cilat kanë programe pothuajse të njëjta, ashtu sikurse kanë edhe anëtarësinë e njëjtë. „Besoj se koha po vjen, koha po flet... Besoj se do të krijohet momentumi për këtë bashkim“, ka deklaruar Haziri për Express, të martën. Ai ka insistuar që ky proces të kuptohet si një shkrirje e natyrshme, e jo si një bashkim. „Kthimi në LDK është i natyrshëm, është kthim si në shtëpinë e vet“. Edhe më parë ka pasur përpjekje për bashkimin e këtyre subjekteve, por nismat kryesisht kanë ardhur nga anëtarësia dhe zyrtarë të rangut të ulët. Tash, nëse ka vullnet të dyanshëm, një bashkim mes LDK'së dhe LDD'së mund të bëhet në zgjedhjet lokale të 15 Nëntorit. Një mundësi e tillë hedhet poshtë nga Nënkryetari i LDK'së, Lutfi Haziri. „Nuk mund të them asgjë, sepse nuk kemi biseduar. Një është e qartë se LDK ka vendosur që të ketë koalicione parazgjedhore në të gjitha komunat. Kjo i hapë rrugë të gjitha partive“, ka thënë ai. Sipas Hazirit, në këtë garë LDK'së mund t'i bashkohen të gjitha subjektet, përveç PDK'së Hashim Thaçit. „Për koalicione mund të vendosin vet degët e LDK'së. Por ato nuk mund të lidhin koalicione me PDK'në, sepse atë e kemi konkurrent“, ka thënë Haziri. Në një vijë me Lutfi Hazirin është edhe Astrit Haraqija, anëtar i Kryesisë së LDK'së. „Jo, për bashkim nuk ka nevojë. Por ata lë të kthehen në partinë e vet, në LDK. Derën e kanë të hapur. S'ka kurrfarë problemi, ne edhe më parë ju kemi bërë ftesë atyre publikisht“, ka thënë Haraqija për Express. Aktualisht LDK në Parlamentin e Kosovës ka 24 deputetë, derisa LDD 11 deputetë. Partia më e madhe në Kosovë, PDK, ndërkaq, ka 37 deputetë. Një bashkim i mundshëm i LDK'së dhe LDD'së mendohet se do t'i shndërronte ata në forcë kredibile. Megjithëkëtë, jo pak zyrtarë të të dyja partive kundërshtojnë opsionin e bashkimit. Lulzim Zeneli, Sekretar i Përgjithshëm i LDD-së, është njëri nga ata. „Kjo është një dezinformatë. Është pjesë e propagandës që individë të caktuar po i plasojnë në media. Nuk bëhet fjalë për një bashkim, pasi që një gjë e tillë asnjëherë nuk është diskutuar“, ka thënë Zeneli për Express. Ai madje ka mohuar se ka presione nga figura të njohura të LDD-së për t'u bashkuar me LDK-në. „Deklarimet e individëve mbesin të individëve“, ka thënë ai, duke folur rreth deklarimeve të Nënkryetarit Berim Ramosaj. „LDK dhe LDD janë subjekte në veti, kanë strukturat e veta, dhe këto i konsiderojë më shumë si tendencë e dikujt për me qenë në agjenda mediale“, ka shtuar ai.

*„Express“*

# Ministria e Mjedisit, plan veprimi për speciet invazive në vendin tonë

## *Plani përfshin objektiva dhe masa për katër fusha të rëndësisë së veçantë*

**Denada Vata**




Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave ka ndërmarrë një plan veprimi për të parandaluar dëmet që mund të shkaktojnë rreziqe të specieve invazive (joautoktone), të pranishme tashmë në vendin tonë kundrejt tipave të ndryshme habitatesh dhe një diversitet të lartë biologjik. Sipas të dhënave nga kjo ministri aktualisht rreth 10% e florës së vendit klasifikohet, apo përfaqësohet nga llojet joautoktone, apo të natyralizuar (speciet aliene). Vetëm një fraksion i vogël i numrit të përgjithshëm të specieve bimore të introduktuara kanë qenë të suksesshme dhe janë stabilizuar në mënyrë të përhershme në ekosistemet autoktone. Ndërkohë, nuk ka një numër të saktë të këtyre specieve në vend. Ndër speciet bimore aliene me ndikim negativ në biodiversitetin shqiptar, përmenden Elode e Kanadasë, e pranishme në përroin e Tushemishtit, Akacia, me origjinë nga juglindja e SHBA-ve dhe e pranishme pothuajse në të gjithë vendin, apo Akacia Bregdetare, me origjinë nga Australia Perëndimore, e pranishme ë zonën e Divjakës, etj. Edhe pema e mimozës klasifikohet specie aliene për Shqipërinë. Origjina e saj është nga Australia Perëndimore dhe një shembull i përhapjes në mënyrë të pakontrolluar është në rrethin e Tiranës, në pjesën lindore të tij (Linzë). Bimë të klasifikuara specie aliene janë lule akulli (nga Afrika e Jugut), plepi kanadez (Amerika e Veriut), etj. „Por, edhe pse niveli i specieve bimore aliene të introduktuara në Shqipëri është i madh, shkalla e rrezikshmërisë për biodiversitetin aktualisht nuk është i një niveli shumë të lartë“, pohon kjo ministri. Sipas MMPAU, disa specie nuk janë të dëmshme për biodiversitetin, megjithatë ato kanë ndikimin e tyre dhe në bujqësi. Ndër speciet shtazore në Shqipëri në gjendje të egër (gjithsej 5438), 47 janë invazive. Kështu, në vend gjenden 70 gjitarë, 343 shpendë, 313 peshq, 36 reptilë, 15 amfibë, 520 molusë, 115 krustacetë, 46 ekinodermatët, 4000 insekte. Ndër speciet invazive janë 21 insekte, 18 peshq, 1 molusk, 1 krustace, 5 gjitarë dhe 1 nematod. Midhja zemër, buburreci i fasules, mushkonja tigër aziatike, flutura e patates së ëmbël, etj, janë specie aliene negative për vendin tonë. Ndër peshqit janë krapi prusian (Liqeni i Prespës), krapi krucian, i introduktuar për herë të parë në liqenin e Tiranës në 1959, barkaleci, apo peshku mizë i Azisë, që konsiderohet si një ndër 100 speciet inavazive më të këqij në botë, trofta e brigjeve në Liqenin e Ohrit, etj. Ndër gjitarët janë miu i arave, kastori, lepuri europian, etj.

Përhapja e llojeve invazive, është bërë me qëllim, apo pa dashje, për shekuj me radhë. Ky proces është nxitur së fundi nga zhvillimi i transportit, tregtisë, udhëtimeve, turizmit, globalizimi i tregjeve, etj. Speciet invazive renditen në shkakun e dytë më të rëndësishëm për humbjet e diversitetit global, pas shkatërrimit të drejtpërdrejtë të habitatit. Ndikimi i specieve invazive në ekosistemin e një vendi mund të jetë i shumëllojshëm. Rreth 80 % e të gjitha llojeve të rrezikuara në botë mund të kenë humbje, si pasojë e konkurrencës nga llojet inazive, apo nga grabiqariteti i tyre. Speciet invazive ndikojnë dhe në ekonominë e një vendi. Kështu, kostot ekonomike ndahen në kosto direkt të humbjeve të prodhimit në agrikulturë dhe në kosto menaxhimi të llojeve invazive. Përveç kësaj, kosto mund të ketë dhe nga ulja e turizmit. Ndikimi i specieve invazive në ekonomi mund të demonstrohet, nëse analizohen sektorë të ndryshëm si tregtia, bujqësia turizmi dhe shëndeti publik. Sipas ministrisë së Mjedisit, shumë bimë të introduktura konkurrojnë në kullota me bimët autoktone dhe janë toksike për gjedhët dhe jo të ngrënshme. Në vendin tonë problemet ekonomike të lidhura me bimët invazive janë kryesisht në bujqësi dhe në sektorin e pyjeve, apo dhe në ujëra, duke krijuar probleme me mirëmbajtjen e tyre. Disa nga speciet ndikojnë negativisht në një sërë karakteristikash mjedisore, sikurse cilësia dhe sasia e ujit, diversiteti i bimëve dhe kafshëve dhe shumëllojshmëria e llojeve. Ndërkohë, sëmundjet joindigjene ndikojnë në shëndetin e njerëzve dhe gjithashtu në kostot për shëndetin. Rritja e rrezikshmërisë vjen nga lloje të ndryshme insektesh, si p.sh. ato që shkaktojnë epidemitë. MMPAU dhe Banka Botërore kanë ndërmarrë tashmë studimin mbi speciet invazive në vend, duke hartuar dhe planin përkatës të veprimit, i bazuar në kërkesat ndërkombëtare. Plani përfshin objektiva dhe masa për katër fusha të rëndësisë së veçantë, duke i dhënë rëndësi informimit dhe ndërgjegjësimit të opinionit publik. Pikësynimi i planit të veprimit për speciet invazive është promovimi i zhvillimit dhe zbatimit të masave të koordinuara për të parandaluar apo minimizuar ndikimet e ndryshme që kanë llojet invazive në biodiversitet, ekonomi dhe shëndetin publik. Qëllimet e këtij planveprimi janë ndërgjegjësimi për çështjet e lidhura me speciet invazive dhe mekanizmat e kontrollit, vendosja e prioriteteve në listën e veprimeve për zbatimin në nivel kombëtar dhe rajonal, aftësimi i strukturave të shtetit që studiojnë speciet invazive si dhe rritja e bashkëpunimit midis tyre, parandalimi i hyrjes së llojeve të reja invazive dhe aftësimi për përgjigje të shpejta, reduktimi i llojeve të introduktuara ekzistuese, rikuperimi i llojeve autoktone dhe restaurimi i habitateve dhe ekosistemeve natyrorë të prekur nga pushtimet biologjike. Llojet më me përparësi janë përzgjedhur ato që përbëjnë kërcënim për diversitetin biologjik, por në konsideratë janë marrë kryesisht ato që kanë ndikim negativ ekonomik, si dhe shëndetësor. Ndërgjegjësimi i opinionit publik është një hap me rëndësi në këtë drejtim, pasi futja në vend e specieve invazive bëhet në një farë mase të madhe nga vetë njeriu. Komunikimi teknik i diferencuar mes autoriteteve shtetërore dhe publikut të gjerë është një hap thelbësor në drejtim të rritjes së njohurive. Ngritja e kapaciteteve, si dhe zhvillimi i njohurive nëpërmjet kërkimit shkencor, janë po ashtu elementë të rëndësishëm të zbatimit të këtij plani.

Shqipëria duhet të zhvillojë planet dhe kërkimet e saj në harmonizimin e monitorimit kombëtar të biodiversitetit. Konventa për Diversitetin Biologjik e Kombeve të Bashkuara, ku Shqipëria është palë nga viti 1994, kërkon që anëtarët të parandalojnë introduktimin, të kontrollojnë, apo të çrrënjosin speciet aliene që kërcënojnë ekosistemet, habitatet e speciet. Parimet udhëzuese për speciet aliene u përcaktuan në 2002 në Konferencën e 6-të të anëtarëve të Konventës për Diversitetin Biologjik.

## Ujërat e lumenjve dhe liqeneve, në gjendje të qëndrueshme

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave në raportin e fundit të gjendjes së mjedisit bëri të ditur se ujërat e lumenjve Drin dhe Mat janë të cilësisë së mirë. Të dhënat e raportit të Ministrisë së Mjedisit tregojnë për një gjendje të qëndrueshme të cilësisë së ujërave të liqeneve dhe lumenjve tanë. Ujërat e lumenjve Erzen, Seman, Shkumbin, Vjosë dhe Bunë janë të cilësisë mesatare me tendencë të qëndrueshme gjendjeje. Ndërsa, lumi i Ishmit dhe Gjanica rezultojnë më të ndotur. Përsa i përket cilësisë së ujërave të liqeneve, ai i Ohrit rezulton i cilësisë shumë të mire. Ujërat e liqeneve të Shkodrës dhe Butrintit sipas të dhënave, janë të cilësisë mesatare, ndërsa të liqenit të Prespës janë në nivelin mesatar, por drejt një cilësie më të ulët. Monitorimi, sipas kësaj ministrie, është realizuar në ujërat sipërfaqësore (liqene, lumenj, zona bregdetare, shkarkime urbane) dhe në ujërat nëntokësore, në zonat më problematike përsa i përket ndotjes së tyre, ku janë matur 18 tregues fiziko-kimike (pH, toC, saliniteti, lënda pezull, oksigjeni i tretur, NKO, NBO, $NH_4$, $NO_2$, $NO_3$, $PO_4$, P-tot. Cd, Hg, Ni, Pb, etj. Ky monitorim është realizuar në 32 stacione lumore (Drin, Bunë, Mat, Erzen, Ishëm, Shkumbin, Seman dhe Vjosë) dhe në 5 stacione liqenore (Liqeni i Shkodrës, Prespës dhe Ohrit). Raporti i Gjendjes së Mjedisit, i bazuar në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, është realizuar nga Rrjeti i Agjencive të Mjedisit në nivel qendror dhe qarku dhe nga institucionet shkencore si Instituti i Ujit, Energjisë dhe Mjedisit, Instituti i Shëndetit Publik, Qendra e Fizikës Bërthamore të Aplikuar, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Fakultetet e Universitetit Bujqësor, etj.

## Siguria ushqimore në vend, nën kontroll të vazhdueshëm

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe strukturat e kontrollit veterinar kanë forcuar masat për rritjen e sigurisë ushqimore në vend, me qëllim uljen e informalitetit në këtë sektor dhe të shkallës së ushqimeve të skaduara në treg, veçanërisht tani në stinën e verës. Valbona Paluka, drejtore e Përgjithshme e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në MBUMK, tha dje se „siguria ushqimore është një nga prioritetet e aktivitetit të saj, pasi ajo është e lidhur drejtpërdrejt me shëndetin e konsumatorëve“. Sipas saj, po i kushtohet rëndësi kontrollit të ushqimeve gjatë gjithë procesit zinxhir të prodhimit dhe tregtimit të tyre, rregullave specifike të kontrollit të produkteve ushqimore me origjinë shtazore, të monitorimit të produkteve të detit, vlerësimi i sistemeve të sigurisë për prodhimet e mishit, etj. „Në të gjitha inspektimet që kemi bërë në 12 qarqe të vendit,- thotë Paluka,- nuk ka pasur raste të evidentuara të shkeljes së kritereve për cilësinë dhe sigurinë e ushqimeve, qofshin këto produkte të prodhuara në vend, apo të importuar nga jashtë.“ Sipas saj, në këtë sezon veror, MBUMK po zbaton një plan specifik, në 12 qarqet e vendit duke intensifikuar kontrollet e inspektimit si në zonat me intensitet më të madh njerëzish, siç janë zonat turistike, por edhe në të gjithë Shqipërinë. Ndërkohë, thekson Paluka, po punojmë për vënien në funksionim të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, si dhe jemi në kontakt të vazhdueshëm me partnerë të Komisionit Europian si Organizata Botërore e Epizotive (OIE), Drejtorinë e Përgjithshme të Shëndetit Publik të Komisionit Europian etj, për zhvillimet mbi rritjen e sigurinë ushqimore.

# Ulja e çmimeve në tregun botëror, rrit shitjen e makinave të reja në Shqipëri

*Infrastruktura rrugore, e cila vitet e fundit ka njohur një përmirësim rrënjësor, është një nga faktorët që shqiptarët blejnë makina më ekonomike e jo domosdoshmërisht "të forta"*

Albana Kamberi

Kriza që ka përfshirë ekonominë botërore, ka ndikuar në shumë fusha të jetës, duke përfshirë këtu edhe tregun e makinave te reja. Por, nëse në të gjithë botën kjo krizë pati efekte negative, në Shqipëri, numri i shitjeve të makinave të reja është rritur në mënyrë të ndjeshme. Sipas drejtorit të shitjeve të filialit të kompanisë Ford në vendin tonë, Gentian Karaj, gjatë 6 mujorit të parë të këtij viti janë rritur me 50% shitjet e makinave, si pasojë e uljes së çmimeve në tregun botëror. Ndërkohë, sipas agjentëve të shitjeve të filialeve të markave të makinave në vend vihet re një tendence në rritje e makinave me leasing, ku sipas statistikave 70% e shitjeve bëhen me leasing Pas viteve 90-të në vendin tonë pati një „bum" të hyrjeve të makinave të përdorura, pasi çmimi i ulët favorizoi shqiptarët për të pasur një mjet në pronësi. Por kjo tendencë u ul vitet e fundit kur po shfaqet mania për të blerë makina të reja, kjo edhe nga vendosja e taksave të larta për makinat e përdorura. Ato variojnë nga 10 mijë euro më e lira deri tek 100 mijë euro më e shtrenjta. Sipas kompanive të mëdha si Wolfswagen, Mazda, Mitsubishi, etj, çmimet në këto kompani nuk kanë lëvizur. Por, makinat e reja më të shitura në tregun shqiptar mbeten „Golfi" dhe „Polo", të cilat kanë edhe një çmim më të arsyeshëm për tu blerë. Këto dy marka janë më të kërkuarat, pasi janë mjaft të preferuara edhe nga femrat. Të tjerë faktorë që ndikon në përcaktimin e markës së makinës për klientët, janë edhe çmimi i lartë, pjesët e këmbimit dhe konsumi i karburantit, të cilët i detyrojnë njerëzit të shohin drejt makinave ekonomike me fuqi motorike më të ulët. Rritja e çmimit të „arit të zi" sipas ekspertëve të kësaj fushe e ka bërë shumë të kushtueshme mbajtjen e një makine me cilindratë të lartë. Ndërsa për të marrë vendimin për të blerë një makinë me fuqi motorike të vogël është edhe infrastruktura rrugore, e cila vitet e fundit ka njohur një përmirësim rrënjësor, duke i lejuar blerësit qe të mos preferojnë medoemos një makinë të „fortë", për të përballuar amortizimin e tyre. Rritjen e kërkesës për makina më ekonomike, krahas arsyeve të mësipërme distributorët ia atribuojnë edhe mbështetjes ekonomike që ofrojnë bankat ndaj blerësve. Por tregu i makinave të përdorura ka njohur rënie për shkak të rritjes së tarifës së zhdoganimit të makinave e cila ka sjellë një rritje të ndjeshme të çmimit të tyre në këtë treg.



## Kurse trajnimi profesional për menaxhim me lektorë austriakë

"Qendra e Kërkimeve dhe e Trajnimeve për Biznesin" e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës (DHTIT), në bashkëpunim me partnerin e saj WIFI Austria (Instituti për Nxitjen e Zhvillimit Ekonomik) i Dhomës Ekonomike Federale të Austrisë, vazhdon organizimin e kurseve të trajnimeve profesionale për menaxhim. Sipas burimeve nga DHTIT, kurset do të zhvillohen nga lektorë austriakë dhe çdo njeri prej tyre ka tre module, që mund të ndryshojnë në varësi të kërkesave. Në përfundim të kursit pjesëmarrësit i nënshtrohen provimit, lidhur me njohuritë e fituara në të tre modulet. Atyre që ndjekin rregullisht kursin dhe vlerësohen pozitivisht në provim, u jepet mundësia për një vizitë 4- ditore në Austri.

Moduli i parë (17-19 shtator) do te ketë si teme „Marketimi dhe planifikimi i biznesit", moduli i dytë temën „Menaxhimi i projektit – strategjia dhe burimet njerëzore", ndërsa moduli i tretë temën „Financimi, kontrolli dhe testimi i eksporteve". Provimet për të tre modulet do të zhvillohen më 8 tetor, ndërsa vizita në Austri do të kryhet më 2-6 nëntor. Gjatë vizitës 4-ditore në Austri, fituesve të provimit u jepen certifikatat përkatëse (nga WIFI Austria), të njohura në të gjitha vendet e Europës, do të organizohet një takim në Dhomën e Ekonomike të Austrisë, si dhe do të zhvillohet një forum biznesi ndërmjet të dy vendeve, ku biznesmenët shqiptarë, që kanë marrë pjesë në trajnim, do të kenë mundësinë e kontakteve me bizneset vendase për shkëmbim përvoje e bashkëpunim.

## ISHP: Rritet numri i femrave duhanpirëse në vendin tonë

Duhapirja në vendin tonë paraqitet në shifra të larta, sidomos tek meshkujt, ndërkohë që po vihet re dhe rritje e numrit të femrave duhanpirëse. Me qëllim marrjen e informacionit dhe vlerësimin e situatës, specialistët e shëndetit publik ndërmorën një studim në komunitetin e Kamzës, një zonë rreth 10 kilometra larg Tiranës, ku u përfshinë 764 subjekte të banorëve të zonës.

Bazuar në të dhënat e studimit, me kohëzgjatje prej dy vitesh (2005-2007), 50.7% e të intervistuarve referojnë se janë konsumues ditorë të rregullt të duhanit në komunitetin e Kamzës. Një shifër e vogël referojnë se janë duhanpirës jo të rregullt. Ndërsa, rreth 5.8 e subjekteve referojnë se pinë duhan me raste. Por, duhanpirja, si një fenomen që nuk përjashton femrat, rritet në mënyrë të vazhdueshme tek kjo kategori. Bazuar në të dhënat e studimit, 15.6% e subjekteve femra referojnë se janë duhanpirëse të rregullta, çdo ditë, ndërsa 10.3% e subjekteve femra referojnë se pinë duhan me raste. Sipas specialistëve, nëse do të merren në konsideratë të dy rastet e paraqitura në studim, atëherë 29.9% e subjekteve femra janë duhanpirëse (pinë çdo ditë dhe pinë me raste), shifër kjo që flet për një fenomen jo pak të përhapur dhe në subjektet femra në këtë komunitet. Mbledhja e të dhënave të studimit u realizua nëpërmjet vetëadministrimit të një pyetësori. Mesatarja e moshës së subjekteve të përfshirë është rreth 40 vjeç, me kufij nga 14 deri në 94 vjeç, prej të cilëve 55.5% e subjekteve i përkisnin gjinisë mashkullore, kundrejt 44.5% që i përkisnin subjekteve të gjinisë femërore. Sipas shkallës arsimore, 40.1% ishin subjekte me arsim 9 vjeçar, 48.8% me arsim të mesëm dhe 11.1% me arsim të lartë.

Qëllimi i studimit ishte rritja e informacionit mbi duhapirjen në komunitetin e Kamzës për vlerësimin e situatës dhe rritjen e efekteve të parandalimit. Ndërkohë, Instituti i Shëndetit Publik, nëpërmjet Studimit të madh Demografik Shëndetësor synon të sjellë dhe të dhëna të përditësuara mbi duhanpirjen në vend.

## Shërbime dhe imazh të ri në qendrën spitalore "Xhafer Kongoli"

**Qeveria Shqiptare e ka përfshirë spitalin e Elbasanit ndër 8 spitalet rajonale të vendit, që do të përfitojnë nga granti 10 milionë dollarë i qeverisë japoneze në muajt e parë të vitit që pason**

*Shërbimet e reja sikurse janë dializa ekstraperitoneale, kirurgjia laparoskopike, etj, ofrohen tashmë dhe në qendrën spitalore „Xhafer Kongoli" në qytetin e Elbasanit, si sfida ndaj globalizimit. Drejtori i Qendrës Spitalore „Xh.Komgoli", Arben Paralloi, tha dje se shumica e arritjeve janë shënuar brenda një harku kohor prej një viti e gjysmë. Vetëm gjatë 6-mujorit të parë 2009, në këtë qendër janë kryer një sërë investimesh. Ndër to veçohen investimet për përmirësimin e kushteve të hotelerisë, spitalin e ri kirurgji-maternitet, për të cilin po financohen 2.4 milion euro, instalimi i ngrohjes për urgjencën dhe radiologjinë, përshtatja e projektit për ndërtimin e bllokut kirurgji- maternitet sipas Master-Planit të ri të Spitalit, projekti për rikonstruksionin e godinës së ish-kirurgjisë dhe lidhjen midis godinave ekzistuese dhe bllokut të ri kirurgji-maternitet, aparaturën mjekësorë skopi-grafi e instaluar në Poliklinikën e Specialiteteve, etj. „Për 6-mujorin e dytë të vitit 2009, me rritjen e të ardhurave dytësore do të blejmë krevate për fëmijë të porsalindur, kondicionerë, frigoriferë për farmacinë dhe pajisje teknologjike për repartin e prapavijës", tha Paralloi. Përveç investimeve për vitin 2009, nga buxheti i shtetit për spitalin e Elbasanit, u aprovua dhe blerja e një mamografie, fjala e fundit e teknologjisë dixhitale që do të mundësojë depistimin masiv të grave për kancerin e gjirit, krahas aparaturave të tjera. Paralloi tha se Qeveria Shqiptare e ka përfshirë spitalin rajonal të Elbasanit ndër 8 spitalet rajonale të vendit, që do të përfitojnë nga granti 10 milionë dollarë i qeverisë japoneze në muajt e parë të vitit që pason. „Kemi mbyllur të gjitha takimet me delegacionet japoneze dhe kemi aprovuar listën e aparaturave që do të vijnë pas disa muajsh në spitalin tonë", shton Paralloi. Ndër to pritet të sigurohen akaneri (tomografi kompjuterike), aparat grafie C- ARM, fluroskopi dixhitale, ultrasound, defibrilatorë, monitorë pacienti, EKG, centrifugë, autoanalizator gjaku, fotometër. aspirator, pajisje të ndryshme për shërbimin e urgjencës, etj. „Autonomia që na jep fillimi i reformës, tenderat elektronike që kemi kryer vetë si spital, janë përkthyer në furnizim pa ndërprerje duke fituar aktualisht një imazh shumë më të mirë para syve të qytetarëve", përfundon Paralloi.*





## NOBEL
Shkolla 12-vjeçare jopublike

## Shkolla që sfidon të ardhmen

## REGJISTRIMET FILLUAN

- Shkollë me standarte të njëjta me ato të vendeve europiane e amerikane.
- Mbështetet financiarisht nga "Taçi Oil Company"
- Laborator cilësor informatike, fizike, kimie dhe klasa modern për të gjitha ciklet
- Lënda e kompiuter-informatikës fillon në klasën e katërt fillore deri në të 12-tën me dy orë në javë.
- Interneti ofrohet 24 orë në ditë falas.
- Tre katerdra të gjuhës së huaj: Anglisht, Gjermanisht, Italisht.
- Lënda e vallëzimit zhvillohet në të gjitha klasat e shkollës 9-vjeçare
- Transporti realizohet me mikrobusët e shkollës.

Shkolla që sfidon të ardhmen

Adresa: Kilometri i parë Tiranë-Durrës pas Vodafone Albania Sh.a.

Kontakto: 0692099430; 0692076801







# ALVENTA finanza strategica NË SHQIPËRI











## "Alventa", ikona italiane e konsulencës financiare, tani në Shqipëri

*Investitorë të fuqishëm italianë kanë marrë këshillat e grupit të konsulencës juridike e financiare "Alventa" për të kryer investime të fuqishme në Shqipëri, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Suksesi në operacione të fuqishme financiare e kanë shndërruar "Alventa"-n në një grup konsulence shumë të kërkuar, në kushtet e një ekonomie botërore, gjithmonë e më të globalizuar.*

## Alventa - stafeta e suksesit

*Konsulencë në politikat fiskale*
*Ndihmë në vendosjen e partneritetit me autoritetet lokale;*
*Kapërcimi i shpejtë i pengesave burokratike, duke garantuar një qasje të shpejtë në procedurat për marrjen e punëve publike;*
*Vendosja e marrëdhënieve me institucionet ndërkombëtare huadhënëse dhe garantimi i një partneriteti me autoritetet lokale për një qasje më të mirë në linjat e kreditimit;*
*Konsulencë juridike për vlerësimin dhe hartimin e kontrat-ave, duke përfshirë kryerjen e negociatave deri në mbylljen e marrëveshjeve të partneritetit*

**ALVENTA SRL** Viale Europa, 72 36075 Mnotecchio Maggiore (VI) tel/fax 0039 444 699 926
P.IVA/C.F. 03499130247 Iscrizione REA VI - 0330179 **info@alventagroup.com www.alventagropu.com**

INTERVISTA

# Vendimi i akreditimit të universiteteve të Kosovës s'ka prapavijë politike



**Ministri i Arsimit i Kosovës, Enver Hoxhaj, e ka cilësuar vendimin e qeverisë për akreditimin e kolegjeve dhe jo Universiteteve të sektorit privat, si një mbështetje për bartësit privat të arsimit të lartë dhe ka theksuar se vendimi është bazuar mbi raportin e akreditimit të Këshillit Britanik vitin e kaluar. Zoti Hoxhaj në një intervistë me BBC-në, thotë se vendimi i qeverisë që të mos lejojë këto institucione që të japin tituj akademikë dhe të mos organizojnë programe të doktoraturës është perspektiva më e mirë se si në të ardhmen këto institucione do të zhvillohen**

**A është marrë vendimi i qeverisë pasi vlerësimet për këto institucione private zbuluan dobësitë e tyre?**

Mendoj se procesi i akreditimit gjatë vitit 2008-2009, në të cilin kanë qenë të përfshirë mbi 100 ekspertë dhe raporti përfshinë mbi 1800 faqe tekst, është një vlerësim real i gjendjes ekzistuese në të gjithë këto Institucione të arsimit të lartë në Republikës së Kosovës. Vendimi i Qeverisë, i cili mbi të gjitha I referohet rekomandimit të Këshillit Kombëtar të Cilësisë që asnjë prej tyre të mos bartë emrin Universitet, që të mos jap tituj akademik dhe të mos organizojë programe të doktoraturës, është realisht dizajni më i mirë i mundshëm se si në të ardhmen këto Institucione të arsimit të lartë të zhvillohen. Ndërsa studentët që janë në këto Institucione ta kenë mundësinë që vërtetë të ndjekin programe të akredituara dhe diplomat e tyre të pranohen brenda dhe jashtë Kosovës.

**Ky është qëndrimi i qeverisë së Kosovës dhe Këshillit Kombëtar për Akreditim. Por a është ky edhe qëndrim i ekspertëve të përfshirë në procesin e vlerësimeve dhe rekomandimeve për këto Institucione të arsimit të lartë?**

Definitivisht, çdo ekspert që ka qenë i përfshirë në procesin e akreditimit të çdo institucioni të arsimit të lartë, veç e veç, të programeve të tyre, ka rekomanduar që mjerisht, asnjë institucion nuk e bartë emrin Universitet, por këtu dilemma nuk është tek emri. Dilema është se disa nga këto Universitete kanë bërë një punë jashtëzakonisht të madhe dhe si të tilla mund ta kenë emrin kolegj, të ofrojnë programe të reja të studimit, programe të cilat do të ofrojnë diploma dhe grada të bachelor dhe master të cilat do të pranohen brenda për brenda Republikës së Kosovës dhe me atë ju mundësohet këtyre të rinjve që të studiojnë edhe jashtë Kosovës. Si e tillë, nëse e krahasojmë me vitin e kaluar, ky është zhvillimi më pozitiv që ka Kosova.

**Kur thoni se këta studentë do të mund të studiojnë jashtë vendit. Kjo po i bie se ata duhet edhe njëherë të regjistrohen nga fillimi meqë këto kolegje mund të cilësohen si shkolla profesionale më tepër?**

Absolutisht jo. Çdo gjë që e ka emrin kolegj në botën akademike i referohet asaj që këto janë institucione të arsimit të lartë dhe institucione të arsimit të lartë me emrin kolegj, që kanë mundësinë që të ofrojnë gradën e bachelor dhe master. Përveç kësaj Këshilli Kombëtar i Cilësisë ka rekomanduar se disa nga to të emërohen Institute dhe ju e dini se ka institucione me nam botëror që e kanë emrin edhe kolegj edhe Institute. Ndërsa shkollat profesionale janë ato që ofrojnë kualifikime të cilat mund të zgjasin një ose dy semestra dhe të cilat mbi të gjitha i referohen nevojës të trajnimeve të fuqisë punëtore për ekonominë e tregut.

**Marrë parasysh se keni kufizuar numrin e studentëve në Universitetin e**

Provimin shtetëror të maturës e kanë kaluar 11.600 studentë dhe ne shpresojmë se në afatin e dytë do të ketë edhe 7 mijë ose 8 mijë të tjerë, që realisht Republika e Kosovës mund t'i ketë këtë vit rreth 19 mijë të rinj me provim të maturës

**Prishtinës. Marrë parasysh se keni kufizuar mundësinë e të rinjve që të kryejnë universitetin ju madje e keni kufizuar edhe numrin e studentëve që do të regjistroheshin në këto kolegje...**

Provimin shtetëror të maturës e kanë kaluar 11.600 studentë dhe ne shpresojmë se në afatin e dytë do të ketë edhe 7 mijë ose 8 mijë të tjerë, që realisht Republika e Kosovës mund t'i ketë këtë vit rreth 19 mijë të rinj me provim të maturës. Çdo kush që synon të studiojë në një Universitet ose kolegj do të duhej ta kishte patjetër provimin shtetëror të maturës. Universiteti i Prishtinës, planifikon që sivjet, sipas sugjerimeve tona si Ministri, të pranojë rreth 11 mijë studentë të rinj dhe pjesë tjetër mund të studiojë në kolegje dhe Institute që ofrojnë gradën bachelor dhe master. Mendoj se shumica e këtyre institucioneve kanë bërë një punë jashtëzakonisht të mirë dhe sidomos në traditën e vendeve britanike e amerikane, përdorimi i termit kolegj është i barabartë me fjalën Universitet dhe si të tilla këto Institucione dhe këta studentë duhet ta ndjejnë veten komod sikurse është fjala edhe për studentët që janë në Universitetin publik.

**Vendimi nuk ka prapavijë politike?**

Absolutisht jo. Vendimi është i bazuar në raportin e akreditimit të Këshillit Britanik vitin e kaluar. Nëse ju kujtohet edhe vitin e kaluar, Këshilli Britanik për Akreditim, ka sugjeruar që në Republikën e Kosovës, asnjë institucion të mos ketë mundësinë që ta bartë emrin Universitet por kolegj. Ky është ai vlerësimi i ekspertëve që kemi patur gjatë vitit 2008-2009. Nuk mendoj se këtu çështja duhet të jetë se vërtetë çfarë emri duhet të ketë një institucion por duhet të ketë debat për atë se çfarë cilësie ofrojnë këto institucione. Thash më herët se institucione me nam si MIT ose RIT janë vetëm institute por janë Institucione që kanë një numër shumë të madh të studentëve dhe janë motor të zhvillimit ekonomik dhe të cilat jo vetëm brenda këtyre shteteve kanë reputacion ndërkombëtar dhe në rangimin e institucioneve të arsimit të lartë vazhdimisht prijnë. Ftesa ime për institucionet private është që të shohin se si t'i zbatojnë akreditimet që u kemi ofruar meqë ka shumë punë që ato të zbatohen dhe mbi të gjitha të sigurojnë qëndrueshmëri afatgjate qoftë në punësimin e personelit, meqë një pjesë e tyre ende nuk kanë personel, qoftë në inicimin e projekteve të reja shkencore, qoftë edhe ne definimin e drejtimeve të reja që i shërbejnë zhvillimit ekonomik. Dhe të mos kemi një lloj sektorë të arsimit të lartë ku institucionet e arsimit të lartë janë një lloj kopje e vet arsimit publik, ku shumica e studentëve studiojnë përafërsisht drejtimet e njëjta që ofron edhe UP.

**Por më lejoni zoti ministër. Një pjesë e bartësve të arsimit të lartë privat kanë paralajmëruar se do të ndjekin një rrugë ligjore për të përmbysur këtë vendim të qeverisë.**

Mendoj se çdo kush e ka të drejtën që ta ndjek rrugën ligjore. Ata të cilët janë vërtetë të interesuar që të fillojnë me pranimin e studentëve të rinj dhe ta definojnë misionin e tyre mund ta bëjnë këtë punë kurse të tjerët që janë të interesuar që të mos e marrin licencën në Ministrinë e Arsimit është çështje e tyre individuale. Nëse ka të tillë që janë të interesuar që të mos marrin licencë mund ta ndjekin rrugën ligjore dhe definitivisht procest gjyqësore në Republikën e Kosovës zgjasin shumë gjatë dhe mund të shihemi me këto Universitete pas dy-tri vjetësh dhe ata vendosin për fatin e tyre.

**Pra a mund ta quajmë kështu dënim vendimin e qeverisë së Kosovës?**

Absolutisht jo. Kjo është mbështetje për Universitetet private. Me thënë të drejtën unë nuk e kuptoj edhe frymën e kësaj interviste dhe frymën e kualifikimeve të tilla si dënim meqë më duket se qeveria e Kosovës ka qenë pozitivisht e drejtuar që ta ndihmojë sektorin privat.

DOSSIER

# Cikli: Çorba e vjetër e "Politikës së re"

## Foli edhe Namiku

Dje radhën e protestuesit e kishte kandidati i Partisë Socialiste për Tiranën, ish kryeredaktori i gazetës "Puna" dhe më pas i të përditshmes "Ze(he)ri i Popullit". Dokle që aktualisht mban rekordin si deputeti me më shumë mandate pasi është zgjedhur deputet më 31 mars 1991, 22 mars 1992 (nga listat), 26 maj 1996 (nga listat), 29 qershor 1997, 24 qershor 1997, 24 qershor 2001, 3 korrik 2005 dhe 28 qershor 2008, duke se këtë herë e ka të fundit në legjislativin shqiptar. Afër mendjes të shkon parulla e këtyre zgjedhjeve e Partisë Socialiste dhe kryetarit Edvin, për "politikë të re". Dhe krejt natyrshëm duke pasur në krah të tillë "të rinj" që gjithsesi nuk ndryshonin aspak nga Erion Veliajt apo maznikët e tij, politika e Edvinit nuk pritej të sillte gjëra të reja.

Dikur Dokle "kandidoi" me Ramiz Alinë për t'u bërë president i Shqipërisë në vitin 1991. Dhe kjo jo për ndonjë gjë por sepse Dispozitat Kushtetuese të atëhershme kushtëzonin të paktën dy konkurrentë në votim. Kështu që Namik Doklen e propozuan 33 deputetë dhe në fund fare votuan vetëm 2 vetë. Në atë kohë u tha se ato dy vota ia kishin dhënë për gallatë dy deputetë të opozitës, ndërsa u përhap fjala se Namiku kishte votuar kundër Namikut. Tani si duket pas një heshtje të gjatë, iu desh edhe Namikut të thotë diçka sigurisht në emër të "politikës së re" që përfaqëson Edvin Rama.

Dokle i cili ishte një ndër radikalët e mbledhjes së Byrosë Politike të Partisë Socialiste ku kërkonte të ndërmerreshin veprimet e rrugës pa njohur legjislaturën e dalë nga këto zgjedhje

Por tashmë shihet qartë se Edvini i "politikës së re" po kërkon të mbështetet në radikalizmin e gjendjes, pikërisht nga përfaqësuesit më tipikë të politikës së vjetër puniste, pikërisht ata që i kanë qëndruar çdo kohe. Por siç po vinë punët dihet tashmë se kjo punë u bë si punë dezhurni. Por grafiku i ka caktuar disave nga dy – tre herë në javë.



Dikur Dokle "kandidoi" me Ramiz Alinë për t'u bërë president i Shqipërisë në vitin 1991. Dhe kjo jo për ndonjë gjë por sepse Dispozitat Kushtetuese të atëhershme kushtëzonin të paktën dy konkurrentë në votim. Kështu që Namik Doklen e propozuan 33 deputetë dhe në fund fare votuan vetëm 2 vetë. Në atë kohë u tha se ato dy vota ia kishin dhënë për gallatë dy deputetë të opozitës, ndërsa u përhap fjala se Namiku kishte votuar kundër Namikut



## Hartimi i ajolës

Ka nisur me hartime dëshpërimi i anëtares së Asamblesë së Partisë Socialiste me emrin ajola, vajzës që në një emision televiziv, psherëtinte e çuditur fjalët me ton fëminor: "Po unë nuk jam politikane". Tashmë në gazetën e çunit të Zaimit, ajola ka bërë një hartim. Ka marrë temën nga mësuesi i lëndës dhe ka zhvilluar fantazinë duke e përfytyruar situatën paszgjedhore në atë të një qyteti të vogël. Duke që "politikania" e re e Asamblesë së Partisë Socialiste (që dikur quhej Komitet Qendror apo më tej KPD), pasi ka deklaruar se nuk ishte politikane, tani kërkon të gjejë veten emocionalisht për humbjen e "politikës së re", apo të derivatit të saj 99-sh të formës "Do t'ia dalim". Së paku ajola mund të na bënte një hyrje ku të na tregonte "politikën e re" që përfaqësohet nga ministri i fundit i Sigurimit të Shtetit në gjithë lindjen komuniste, nga ish-ministra të diktaturës apo nga ana tjetër e 99-shave e përfaqësuar nga pinjollët e kryetarëve të degëve të punëve të brendshme. Por ditën e djeshme, Ajola u shfaq me emocionin e një fëmije që pasi i kanë marrë mollën, qan derisa t'ia kthejnë prapë.

Tashmë tema e hartimit kishte në thelb "kameleonët". E gjora ajolë, quan "tradhti" të madhe faktin që një koalicion merr drejtpërdrejt votat dhe merr pjesë në qeverisje në bazë të votave që ka marrë, krejt ndryshe nga partia që mbron ajola, e cila i nxori paratë sheshit për të blerë votat më 28 qershor.

Hartimi i ajolës kishte ulje e ngritje të menjëhershme, por brenda tij ishte i palëvizshëm zemërimi, sepse ata, "do t'ia dilnin". Sepse ata ishin e "mira" e këtij vendi sepse ishin bashkuar gjobitësit e lejeve të ndërtimit, bijtë e nomenklaturës komuniste, e për këtë gjë vendit i paraqitej realisht një kërcënim.

Por dëshpërimi më i madh për njeriun që protagonizmin e shikon jo nga sakrificat por nga gjërat që i merr të gatshme, janë hartimet fëminore si ky që pamë dje. Por ajola e vogël duhet ta dinte së paku që pjesëmarrja në vendimmarrje nuk është si ajo puna e "Mjaftit" që bashkohen ca çuna e ca goca, pinë ca gota alkool, bërtasin para dy vetëve në lulishte e u duket se po përfaqësojnë rininë apo "shoqërinë civile".

Në të ardhmen presim hartime më të larta se niveli i klasës së katërt. Së paku të kapë klasën e nëntë.

## Gazetat e Edvinit, në garë me njëra – tjetrën për "manipulime"

Duket që gazetat e Edvinit kanë të njëjtin ritëm përsa i takon "manipulimit" të zgjedhjeve. Një përditshme, botuesi i së cilës e la unazën e Tiranës dy vjet në mes të baltës dhe pluhurit pasi kishte tharë edhe tendera të tjerë e nuk i prishte punë fare të zgjaste mërzinë e jetës së qytetarëve të kryeqytetit, ka vijuar me "prova" të forta për "manipulimin" e zgjedhjeve. Në të njëjtin kënd vetëm sa ndërrohet qarku. Del një nga ata që janë tashmë deputetë të sigurt të PS-së, flasin nja dy fjalë, dhe kjo përbën lajmin e "madh" se në atë qark zgjdhjet ishin manipuluar. Medet çfarë teknologjie.

# Shqipëria dhe shpëtimi i hebrenjve



Nga Patrice Najbor



**Në fakt, Sir Martin Gilberti në veprën e tij “Winston Churchill : le prophète de la vérité” tregon për një përpjekje të bërë në janar 1939, në të cilën një diplomat shqiptar, i dërguar nga mbreti Zog, ka propozuar ta bëjë Shqipërinë një vend të shenjtë mbrojtës për hebrenjtë**

Shqiptarët ishin kombi që gjatë Luftës së Dytë Botërore ishin ndoshta të vetmin që treguan një mikpritje të veçantë ndaj hebrenjve, në kushtet e sundimit të ideologjisë naziste. Kjo sigurisht nuk ishte rastësi, pasi edhe më parë kur nazizmi nuk ishte në pozitat e luftës së hapur, në Shqipëri kishin gjetur mikpritje edhe hebrenj të tjerë, prej të cilëve më i njohur mbetet rasti i Anjshtajnit. Kjo sepse qysh para 7 prillit 1939, ka pasur bisedime për vendosjen e kolonive hebreje në Shqipëri. Këto projekte kishin një interes të dyfishtë, për t’i dhënë hebrenjve një vend pritës, një tokë azili dhe për t’i sjellë Shqipërisë intelektualë, inxhinierë, mjekë, mësues etj… të cilët do të merrnin pjesë në zhvillimin e vendit. Në këto projekte kishte një aspekt njerëzor dhe një aspekt ekonomik. Përveç të tjerave, këto projekte tregojnë që mbreti Zog, më 1943, po parapërgatiste dhe po punonte për të ardhmen e Shqipërisë.

Në fakt, Sir Martin Gilberti në veprën e tij “Winston Churchill : le prophète de la vérité” tregon për një përpjekje të bërë në janar 1939, në të cilën një diplomat shqiptar, i dërguar nga mbreti Zog, ka propozuar ta bëjë Shqipërinë një vend të shenjtë mbrojtës për hebrenjtë. Për ta bërë këtë, Çurçilli duhej të frenonte vrullin e Musolinit dhe të garantonte pavarësinë e Shqipërisë, në mënyrë që plani i shpëtimit të merrte jetë. Fatkeqësisht Çurçilli e ka lënë mënjanë këtë plan. Sir Martin Gilberti nuk e jep emrin e këtij të dërguari dhe, siç ndodh shpesh gjatë negociatave të fshehta, gjërat mbeten gjithnjë sekrete. Megjithatë ky diplomat mund të jetë Dervish Duma, që ishte sekretari i dytë i legatës shqiptare në Londër dhe që qe emëruar i ngarkuar me punë në fillim të 1939-ës.

Në tërësinë e burimeve për këtë çështje, njëri prej burimeve më të para dhe më të rëndësishme vjen prej arkivave shqiptare. Në “Guide Book, a reference to record about Jews in Albania” të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave në vitin 2006, pasqyrohen dokumentet kryesore të arkivave shqiptare në lidhje me shpëtimin e hebrenjve në Shqipëri. Përsa i përket rastit të fizikanit Albert Ajnshtajn, i cili ka përdorur mundësinë e pajisjes me një dokument shqiptar për të shkuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kemi dëshminë e mbretëreshës Geraldinë (shih edhe intervistën e Mikael de Pok për revistën angleze “Sky” më 2002). Në shumë intervista mbretëresha ka treguar për vizitën sekrete të Ajnshtajnit në Shqipëri përgjatë 48 orëve dhe takimin e tij me mbretin Zog. Kalimi i Ajshtajnit në Shqipëri është konfirmuar në disa drejtime: nga ish-drejtori i asaj kohe i Institutit të Fizikës, zotit Skënder Koja, i cili e kishte takuar atë, nga punonjësi i bankës, Ajet Bega, që po ashtu e kishte takuar (sipas një dokumenti zyrtar, Albert Ajnshtajni ka shkuar në Bankën Shqiptare të Shqipërisë, në Tiranë, më 9 prill 1931) dhe nga doktor Jani Basho, i cili ka shërbyer si ndërmjetës në përpjekjet administrative për marrjen e dokumenteve të udhëtimit dhe që e priti fizikanin kur ai arriti në Durrës. Fatkeqësisht shumica e dokumenteve që lidhen me kalimin e Ajnshtajnit në Shqipëri është djegur më 1945, kur klinika e doktor Bashos ishte bastisur dhe marrë nga partizanët.

Ka tashmë shumë dokumente të legatës italiane që sjellin informacion mbi faktin që familja mbretërore dhe shqiptarët në përgjithësi po mbronin gjithnjë e më shumë hebrenjtë dhe që kjo përbënte “një situatë shqetësuese dhe të rrezikshme” (shënimi i legatës italiane të 16 janarit 1939 – AQSH F.163, V.1939 D.247, fleta 14).

Unë mund të saktësoj më tej që edhe nëse familja mbretërore do të kishte, për shembull, dokumente për vizitën sekrete të Ajnshtajnit në Shqipëri, arkivat që ajo kish-

# dossier





te marrë me vete përgjatë largimit në mërgim janë shkatërruar praktikisht të gjitha, në njërin prej bombardimeve të Londrës.

Është një nder i vërtetë që Shqipëria të ketë familje të vlerësuara "Fisnikë mes kombeve" dhe që familja mbretërore të jetë propozuar nga Norman H. Gershman në katalogun e ekspozitës së tij "Besa: Muslims who saved Jews in World War II" (Syracuse University Press, USA, 2008) për t'u njohur si *fisnikë* (Në këtë ditë, Yad Vashemi njihte zyrtarisht 68 familje shqiptare si "fisnikë"), sepse është një fakt i pamohueshëm që mbreti Zog ka qenë nismëtari i vërtetë i politikës së shpëtimit të hebrenjve nga Shqipëria, duke favorizuar fillimisht ikjen e hebrenjve të persekutuar, duke u dhënë atyre viza turistike dhe tranziti, pastaj duke i kërkuar administratës ndryshimin e emrave, ndërrimin e fesë dhe, më së fundi, duke u dhënë atyre shtetësinë shqiptare.

Kodi i mikpritjes ka bërë të vetën, ai ishte shfaqur dukshëm. Shqiptarët e kanë konsideruar si detyrë që të mbrojnë dhe të fshehin hebrenjtë që i iknin persekutimeve, në një kohë kur kombe të mëdha europiane i përzinin ata. Në Shqipëri nuk ka asnjë listë dhënë fashistëve dhe asnjë internim. Numri i hebrenjve të shpëtuar është vlerësuar në më shumë se 3 000. Më 2005-ën "Memorial Museum of The Holocaust" kishte regjistruar tashmë 2.640.

*Kalimi i Ajshtajnit në Shqipëri është konfirmuar në disa drejtime: nga ish-drejtori i asaj kohe i Institutit të Fizikës, zotit Skënder Koja, i cili e kishte takuar atë, nga punonjësi i bankës, Ajet Bega, që po ashtu e kishte takuar (sipas një dokumenti zyrtar, Albert Ajnshtajni ka shkuar në Bankën Shqiptare të Shqipërisë, në Tiranë, më 9 prill 1931) dhe nga doktor Jani Basho, i cili ka shërbyer si ndërmjetës në përpjekjet administrative për marrjen e dokumenteve të udhëtimit dhe që e priti fizikanin kur ai arriti në Durrës*

**Familja mbretërore e Shqipërisë, si dhe 62 familje të tjera shqiptare, kanë qenë propozuar nga Norman H. Gershman në katalogun e ekspozitës së tij "Besa: Muslims who saved Jews in World War II" (Syracuse University Press, USA, 2008) për t'u njohur si "Fisnikë" nga Yad Vashem.**

**Familje shqiptare të nderuara me titullin e lartë "Fisnikë mes kombesh" nga Yad Vashem . Sipas Norman H. Gershman, paraqitur në katalogun e ekspozitës "Besa: Muslims who saved Jews in World War II", Syracuse University Press, USA, 1st edition 2008**

1. Familja e Destin (Destan?) dhe Lime Ballës;
2. Familja e Baba Haxhi Dede Reshat Bardhit;
3. Familja e Mbretit Zog të Shqipërisë ("King Zog of Albania");
4. Familja e Njazi dhe Liza Pilkut;
5. Familja e Mefail Biçakut;
6. Familja e djalit të tij Njazi Biçaku;
7. Familja e Hysen Marikës;
8. Familja e Jani Kocas;
9. Familja e Islam Prosekut;
10. Familja Domai (Domaj?);
11. Familja e Halil Frashërit;
12. Familja e Toli Dodit;
13. Familja e Aliut (sic!);
14. Familja e Sulo Muzhakës (Muzhaqit?);
15. Familja e Ali dhe Nadire Binxhiut;
16. Familja e Qani Civesë;
17. Familja e Destan Kurmaqut (Kurmakut?);
18. Familja e Besim Zymës;
19. Familja e Higmet/Hiqmet (Meti) Zymës;
20. Familja e Hajdar Kikës dhe e djalit të tij Petrit;
21. Familja e Tef Pogut (Pogës?);
22. Familja e Hysref (Eshref?) dhe Emine Frashërit;
23. Familja e djalit të tyre Mehmet Frashëri;
24. Familja e Osman dhe Nazliko Allah (Alla?);
25. Familja e Esheref dhe Easuere (Qefsere?) Shpuzës;
26. Familja e Ali dhe Rakip Krajës;
27. Familja e Ismail Babanit;
28. Familja Kasapi;
29. Familja e Sulejman dhe Zenepe Meçes;
30. Familja e Lilo Xhimitikut;
31. Familja e Taqi Simsisë;
32. Familja Kurti;
33. Familja e Besim dhe Aishe Kadiut dhe e vajzës së tyre Merushe;
34. Familja Kuqi;
35. Familja e Nuro Hoxhës;
36. Familja e Muhiddin (Muhedin?) Haxhit;
37. Familja e Hasan Kalasë;
38. Familja e Rifat Hoxhës;
39. Familja e Kasem Jakup Kocerrit;
40. Familja e Xhevat dhe Afërdita Gjergjanit;
41. Familja e Vesel dhe Fatima (Fatime?) Veselit;
42. Familja e Mesut dhe Drita Salillarit;
43. Familja e Xhafer Skederit (Skënderit?);
44. Familja e Abaz dhe Zade Sinanit;
45. Familja e Ali dhe Nadia (Nadire?)Kazazi;
46. Familja e Islamit;
47. Familja e Shaqur (Shaqir) dhe Qamile Boriçit dhe e vajzës së tyre Bohriya (Bahrije?) Boriçi;
48. Familja e Ismail Golemit;
49. Familja e Hamid dhe Xhemal Veselit;
50. Familja e Vehbi Hasan Hotit;
51. Familja e Ali Sheqer Pashkajt;
52. Familja e Beqir Qoqjas;
53. Familja Rezniqi;
54. Familja e Hasan Rremë Xerxës;
55. Familja e Ramadan dhe Isa Nuzës;
56. Familja e Mullah Shabanit;
